



UBT NEWS

Gazetë e studentëve të UBT-së | nëntor 2014

POLITICS • ECONOMY • BUSINESS • TECHNOLOGY • EDUCATION • SCIENCE • CULTURE

UBT ORGANIZOI KONFERENCËN E 3-TË NDËRKOMBËTARE PËR BIZNES, TEKNOLOGJI DHE INOVACION



Faqe 3

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME I TOGOS VIZITOI UBT-në



Faqe 4



UNIVERSITETI I PESCI SHTOHET LISTËS SË UNIVERSITETEVE PARTNERE TË UBT

Faqe 7

UBT HAP DYERT PËR TË 12-tin VIT RADHAZI PËR MË TË MIRËT

Faqe 5

UBT-së I AKREDITOHEN PROGRAME TË REJA INOVATIVE DHE I RIAKREDITOHEN PËR PESË VITE

Faqe 5

PËR HERË TË PARË NË BALLKAN

UBT VLERËSOHET ME ÇMIMIN E EKSELENCËS



Faqe 3

EDHE DY PROGRAME TË REJA NË UBT: INXHINIERI E ENERGISË DHE INXHINIERI E ENERGISË EFIÇIENTE

Këto programe do të funksionojnë dhe me anë të mbështetjeje financiare të programit të Komisionit EuropeanTempus. Përmes këtij programi UBT ka ngritur qendrën e ekspertizës dhe laboratorë modernë për Energjinë

Faqe 7

UNIVERSITY EDUCATION FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY
AMERICAN EUROPEAN EDUCATION

ENERGY ECONOMY
SUSTAINABLE DESIGN
ELECTRIC GENERATION AND RENEWABLE ENERGY
ENERGY MANAGEMENT
BIOMASS ENERGY AND ENVIRONMENT

EEE

INXHINIERI E ENERGISË EFIÇIENTE (ENERGY EFFICIENCY ENGINEERING - EEE)
Shkollë profesionale 2 vjeçare (120 kredi), me mundësi vazhdimi në Bachelor 3 vjeçarë (180 kredi) në

INXHINIERINË E ENERGISË (ENERGY ENGINEERING)

TE VETMET PROGRAME TË AKREDITUARA NË KOSOVË

Editorial



Edmond Hajrizi
President i UBT-së

EXCELLENCE - LEADERSHIP - INNOVATION

Të nderuar lexues,

Kjo hapësirë në faqen e dytë të gazetës "UBT news" është një nga format tona të komunikimit, komunikim ky që është i përhershëm, për çështjet shumë të rëndësishme, por edhe për çështje më të thjeshta, me të cilat takohemi në rrugëtimin e pandalshëm të punës sonë.

Në këtë rrugëtim, UBT ju përcjell tash 13 vjet, duke hapur rrugë të reja, duke u bërë shenjë daluese e institucionit që ofron studime cilësore, mundësi të pakrahasueshme dhe cilësi studimesh e hulumtimesh, ndryshe nga të gjithë të tjerët në vend, ndryshe nga institucionet simotra në rajon, asgjë mangut nga institucionet prestigjioze akademike në botë.

Ky është pra UBT, që qysh nga dita e parë ka vetëm një synim, një përpjekje të vazhdueshme drejt CILËSISË - një caku tashmë të arritur, por limitet e të cilit po i shtyjme përpara çdo ditë.

Përkundër faktit se UBT është një institucion i ri, zhvillimi dhe rritja e të cilit ka kaluar nëpër fazën e tranzicionit të vendit, ai ka arritur të ngritë nga dita në ditë, nga muaji në muaj, nga një vit akademik në tjetrin, cilësinë e studimeve, ka arritur njohje dhe vlerësime ndërkombëtare, që e kanë vlerësuar e vërtetuar nivelin kulminant të punës akademike.

Në këtë vazhdë, UBT është vlerësuar me Çmimin e Ekselencës nga Organizata Evropiane për Menaxhimin e Cilësisë (EFQM). Ky çmim prestigjioz, i dhënë për herë të parë në rajonin e Ballkanit për UBT-në, është modeli më i vlerësuar në Evropë për zhvillimin e cilësisë, menaxhimi, lidhshëritë etj.

Dhe ky çmim i madh – Çmimi i Ekselencës – është shenjë dalluese për UBT-në, për të gjithë drejtuesit e mësimdhënësit, për të gjithë studentët, të cilët tashmë kanë edhe një atu më shumë, janë gjithkund më të vlerësuar, janë më ndryshe, janë një hap para të tjerëve.

Çmimi i Ekselencës nuk është më një deklaratë e thatë, një iluzion apo një vizion. Kjo tanimë është realitet në Kosovë.

Ky çmim e radhit UBT-në në listën e organizatave që kanë modelin e organizmit, menaxhimit, lidhshëritë, inovacionit, burimeve njerëzore, përgjegjësisë sociale dhe rezultatet e punës në Evropë dhe më gjerë.

Çkadëshirojmë të konkludojmë me rastin e këtij vlerësimi:

1. Kjo dëshmon se ekziston mundësi e krijimit të sistemeve moderne universitare që i ndërlidhin në vete të gjitha standardet dhe praktikatat më të mira të menaxhimit dhe lidhshëritë në botë edhe në vendet në tranzicion.

2. Gjërat e mira nuk duhet të ndodhin vetëm në disa vende të caktuara dhe të zhvilluara, por ato ndodhin çdokund ku nuk mungojnë angazhimi dhe kreativiteti.

3. Efekti i këtyre sistemeve është shumë më i madh në këto raste dhe dinë të vlerësohen edhe më shumë nga të tjerët.

4. Kosova duhet të besojë se mund të zhvillojë produkte dhe sisteme të cilat janë inovative dhe janë të konkurrencës jo vetëm në vend por edhe në Evropë.

5. Kosova tani ka një institucion të Arsimit të Lartë, i cili i ka tejkaluar të gjitha institucionet tjera në Ballkan sa i përket mënyrës se si punohet dhe si menaxhohet cilësia, ndërmarrësia dhe inovacioni.

Çmimi i Ekselencës është vetëm një prej arritjeve të shumta të UBT-së. Megjithatë, është një vlerësim dhe konfirmim i punës sonë shumë të mundimshme, e cila ia ka vlejtur.



13 YEARS
LEADERSHIP and INNOVATION

Education • Research • Training • Consulting
2001/2014

IMPRESUM

UBT News - Gazetë e studentëve të UBT-së,

Botues: Edmond Hajrizi

Gazetën e përgatitën studentët e Fakultetit për Media dhe Komunikim në UBT.

Koordinatorë për këtë numër: Albina Zeneli

Adresa: www.ubt-uni.net | **Tel:** 038 541 400, 044 541 400

Thyerja Grafike: ELV Studio

Shtypet në Shtypshkronjën «Roto Print»



**UNIVERSITY EDUCATION
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY**

AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

PËR HERË TË PARË NË BALLKAN

UBT VLERËSOHET ME ÇMIMIN E EKSELENCËS NGA ORGANIZATA EFQM

“UBT me të drejtë tani po konsiderohet si ambasador i dijes dhe shkencës në Republikën e Kosovë, pasi gjatë kësaj periudhe kemi marrë disa çmime të rëndësishme ndërkombëtare, çmime dhe certifikime prestigjioze të cilat UBT e bëjnë institucion kredibil dhe të qëndrueshëm në fushën e arsimit cilësor dhe atë ndërkombëtar”, ka thënë presidenti i UBT-së, z. Hajrizi, duke shtuar se këto vlerësime dhe këto çmime janë edhe një promovim i mirë për Kosovën

Prishtinë, 24 shtator 2014 - Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, në një konferencë për media ka shpalosur të arriturat e UBT-së, me theks të veçantë ka folur rreth certifikimeve, anëtarësimit dhe projektet e fituar nga organizata ndërkombëtare gjatë vitit akademik 2014.

“UBT me të drejtë tani po konsiderohet si ambasador i dijes dhe shkencës në Republikën e Kosovë, pasi gjatë kësaj periudhe kemi marrë disa çmime të rëndësishme ndërkombëtare, çmime dhe certifikime prestigjioze të cilat UBT e bëjnë institucion kredibil dhe të qëndrueshëm në fushën e arsimit cilësor dhe atë ndërkombëtar”, ka thënë presidenti i UBT-së, z. Hajrizi, duke shtuar se këto vlerësime dhe këto çmime janë edhe një promovim i mirë për Kosovën.

“UBT-ja nuk po mendon vetëm për veten, por ne po punojmë që përfutur të drejtpërdrejtë të jetë edhe Kosova. UBT-ja ka pasur rezultate, hulumtime, publikime, dhe ka një infrastrukturë moderne, laborator modern dhe të gjitha këto kanë ndikuar që të marrim vlerësime nga të gjitha fushat si për cilësi, menaxhim, leadership etj.



“UBT me të drejtë tani po konsiderohet si ambasador i dijes dhe shkencës në Republikën e Kosovë”

Ndër çmimet, që UBT-ja vlerësohet e para në Ballkan është për Excellence, nga Organizata Evropiane për Menaxhimin e Cilësisë (EFQM), ‘Recognised for Excellence 4 Star, is awarded to UBT- University for Business and Technology’, (EFQM). Ky është modeli më i vlerësuar në Evropë, për zhvillimin e cilësisë, menaxhimi, leadershipit etj. Natyrisht për UBT ka qenë një mision se si të marrim këtë certifikatë nga Evropa për ekselencë, e veçanta tjetër është se këtë certifikatë nuk e ka arritur të marrë deri më tani asnjë vend i rajonit. Kjo është thënë

nga vetë organizata EFQM, tash e tutja Kosova ka një institucion që ka arritur nivelin e excellencës dhe ka dalë mbi vendet e rajonit sa i përket një modeli të tillë”, ka thënë Hajrizi.

Hajrizi ka bërë me dije se UBT-ja certifikohet me çmimin “European Society for Quality Research - ESQR” - Asociacioni Evropian për hulumtimin e Cilësisë, pastaj Organizata amerikane më seli Houstone “CHANGING Business”, e cila ka përzgjedhë UBT-në Kosovë. “Ndërsa çmimi ‘International Star for Leadership in Quality’

është dhënë në bazë të disa kriterëve të rëndësishme, të cilat i ka përmbushur UBT-ja, si në strategjitë e komunikimit, leadership, planifikim dhe vendimmarrjes, edukim i vazhduar dhe trajnim, ISO 9000, etj.

Po ashtu, UBT është ricertifikuar për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë sipas standardit të njohur ndërkombëtar ISO 9001:2008, edhe për tri vitet e ardhshme. Kjo certifikatë është lëshuar pas auditimit dhe raportit pozitiv, nga zyrtarët e institucionit QUALITY AUSTRIA dhe The International Certification Network (IQNet). Ky certifikim tregon se UBT i ka përmbushur të gjitha kriteret e këtij standardi në tërë sistemin e vet. UBT-ja është i vetmi institucion i Arsimit të Lartë në Ballkan, që ka arritur të marrë këtë certifikatë nga viti 2007. IPMA, është anëtare e plotë e organizatë prijëse botërore në fushën e Menaxhimit të Projekteve, e cila certifikon menaxherët e projekteve, krijon ekipe për menaxhimin e projekteve dhe hulumtues të suksesshëm, si dhe nxjerr publikime të ndryshme lidhur me menaxhimin e projekteve, ku UBT është anëtare dhe ka të drejtë të lëshoj certifikime për

vendin dhe më gjerë”, ka deklaruar Hajrizi.

Ai ka shtuar se anëtarësimi i radhës i UBT-së, dhe që është pajisë edhe me certifikatë, dhe i vetmi në Kosovë dhe në Shqipërisë, është në organizatën e parqeve IASO “UBT Science and Innovation Campus member of World Areas of Science, Technology and Innovation (IASO)”.

“Ky vlerësim, nga organizata IASO, ka ardhur pas vizitës nga sekretari gjeneral i kësaj organizate, dhe ka vlerësuar se Kampusi i UBT-së i plotëson standardet për të qenë anëtare e kësaj organizate të parqeve shkencore, teknologjike botërore, dhe ky anëtarësim është i parë në Kosovë dhe në Shqipëri.

UBT është institucioni i vetëm privat që është përfutur e rregullt e projektit ‘Erasmus Mundus’, projekt i Komisionit Evropian.

“Mua më bëjnë motivues dhe inkurajues njëkohësisht këto vlerësime, të cilat janë të dobishme edhe për Kosovën. UBT po bëhet një ambasador i dijes dhe shkencës për Kosovën sepse po arrijmë ta afirmojmë edhe dijen dhe inteligjencën kosovare jashtë vendit”, është shprehur Hajrizi.

NË DURRËS, MË 7 DHE 8 NËNTOR TË KËTIJ VITI

UBT ORGANIZOI KONFERENCËN E TRETË NDËRKOMBËTARE PËR BIZNES, TEKNOLOGJI DHE INOVACION

Në këtë aktivitet janë prezantuar mbi 130 punime nga 200 pjesëmarrës nga e gjithë bota, në 6 konferenca të specializuara në fushën e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri, Sistemet e Informacionit, Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Arkitekturë, Planifikim Hapësinor dhe Ndërtimtari, Mekatronikë dhe Robotikë, Juridik, Shkenca Politike, Media dhe Komunikim

UBT në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Universitetin e Vlorës, Organizatën Evropiane për Cilësi, IFAC dhe shumë partnerë të tjerë ndërkombëtarë, organizuan në Durrës, Shqipëri, në datat 7 dhe 8 nëntor 2014, Konferencën Vjetore Ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacion.

Në këtë aktivitet janë prezantuar mbi 130 punime nga 200 pjesëmarrës nga e gjithë bota, në 6 konferenca të specializuara në fushën e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri, Sistemet e Informacionit, Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Arkitekturë, Planifikim Hapësinor dhe Ndërtimtari, Mekatronikë dhe Robotikë, Juridik, Shkenca Politike, Media dhe Komunikim.

Në fjalimin përshëndetës, rektori prof. dr. Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë e organizimit të kësaj konference dhe vlerat që përfaqëson kjo konferencë për fushat e ndryshme të shkencave me fokus të veçantë inovacionin. “Kjo konferencë ka për objektivi krijimin e një forumi, platforme për studiuesit nga rajoni dhe mbarë bota

dhe të mbështesë cilësinë e kërkimit”. Rektori Hajrizi vlerësoi bashkëpunimin disavjeçar me Universitetin e Tiranës, Universitetin e Vlorës, dhe Universitetin e Vjenës për Teknologji, bashkëpunim i cili është jo vetëm akademik, por dhe në organizimin e konferencave dhe publikimeve të përbashkëta.

Profesoresha Kozeta Sevrani, përgjegjëse në departamentin e Matematikës, Statistikës dhe Informatikës së Aplikuar në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tiranës, shprehu kënaqësinë dhe privilegjin e të qenit pjesëmarrëse në këtë konferencë. “Universiteti i Tiranës së bashku me UBT-në ka krijuar traditën e organizimit të konferencave shkencore duke krijuar kështu një profil, që është në kërkim të zhvillimeve më të fundit të teknologjisë dhe inovacionit”.

Ndërsa zëvendësdekani i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali”, z. Shkëlqim Sinanaj vlerësoi seriozitetin e UBT-së dhe organizimin e kësaj konference, e cila është ndjekur me interes të madh nga studiues nga e gjithë bota.

Në ceremoninë hapëse, drejtoresha për Arsimin e Lartë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, znj. Drita Kadriu përshëndeti në emër të institucionit që ajo përfaqëson, këtë iniciativë të UBT-së duke e parë këtë konferencë si mundësi shkëmbimi përvojash dhe mundësish.

Gjithashtu, drejtori për Shkencë dhe Teknologji në këtë ministri, z. Murteza Osdautaj përshëndeti këtë iniciativë që tashmë organizohet për herë të tretë dhe është një vlerë e shtuar për Kosovën. Ai shtoi se UBT është ndër institucionet e vetme në Shqipëri dhe Kosovë që ka bërë një punë të madhe në fushën e hulumtimit.

Një ndër partnerët më afatgjatë jo vetëm në fushën akademike, por dhe organizimin e konferencave shkencore dhe aktivitetet e tjera të përbashkëta është dhe Universiteti Teknik i Vjenës, përfaqësues i të cilit, prof. dr. Felix Breitenacker, ishte prezent në konferencë dhe shpërgoi skemën e bashkëpunimit disa vjeçar

ndërmjet UBT-së dhe Universitetit Teknik të Vjenës.

Në kuadër të kësaj konference është organizuar dhe tryeza e rrumbullakët me tematikë: “Inovacioni dhe Cilësia në Arsimin e Lartë” ku pjesëmarrës ishin zyrtarë të lartë dhe drejtues të Institucioneve të Arsimit të Lartë, përfaqësues të qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë, ekspertë, profesorë shqiptar dhe të huaj si dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Rekomandimet e kësaj tryeze do të përcillen dhe Ministrive përkatëse të Arsimit në Shqipëri dhe Kosovë.

Në fund të kësaj konference, të gjitha punimet publikohen dhe punimet më të mira do të kenë mundësi të publikohen në revistat më prestigjioze ndërkombëtare

Me anë të kësaj konference vërtetohet më tej kontributi i vazhduar i UBT-së, në ngritjen e kërkimit shkencor si dhe njëkohësisht kjo konferencë shërben si pikë kontakti për profesionistë të disiplinave të ndryshme dhe si një rrjet i UBT-së për krijimin e iniciativave të reja akademike ndërkombëtare.

EDHE NJË PERSONALITET ME RËNDËSI LIGJËRON PARA STUDENTËVE

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME I TOGOS VIZITOI UBT-në

Nga studentët dhe të pranishmit ministri togolez u pyet edhe për disa prej zhvillimeve kryesore politike në kontinentin afrikan, si dhe për angazhimin e mëtutjeshëm për të përhapur në Afrikë, kauzën e njohjes së Republikës së Kosovës

21 korrik 2014- Në UBT ishte për vizitë Ministri i Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit të Togos, Sh.T.Z Robert Dussey, i cili në kuadër të vizitës zyrtare në Republikën e Kosovës, mbajti një ligjëratë para studentëve dhe stafit të UBT-së. Në ambientet e UBT-së, Ministri i Jashtëm i Togos u prit nga stafi drejtues, të cilët i uruan mirëseardhje në emër të presidentit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ndërsa u përshëndet përzemërsisht nga roboti humanoid NAO, i cili e falënderoj



"Me gjithë faktin se Kosova është vend pa dalje në deti, është po aq e rëndësishme të dijë, për faktin se shumica e tregtisë në botë zhvillohet përmes rrugëve detare dhe kjo ka ndikim të jashtëzakonshëm në çdo vend të botës", tha ministri Robert Dussey

Ministrin Dussey për njohjen e Republikës së Kosovës nga Togo. I ftuar për të ligjëruar mbi temën "Siguria detare dhe zhvillimi: Sfidat e Konferencës së Lomes", MJ Dussey foli për zhvillimet e fundit

në këtë fushë në kontinentin Afrikan, dhe sfidat aktuale që përcjellin sigurinë detare.

Ai u tha të pranishmëve se me gjithë faktin se Kosova është vend pa dalje në deti, është po

aq e rëndësishme të dijë, për faktin se shumica e tregtisë në botë zhvillohet përmes rrugëve detare dhe kjo ka ndikim të jashtëzakonshëm në çdo vend të botës. Duke përmbledhur disa prej zhvillimeve kryesore në këtë fushë, dhe Konferencës që pritet të mbahet në kryeqytetin e Togos në Lome, me 2015 për këtë temë, MJ Dussey, u shpreh thellësisht i kënaqur për rolin e tij dhe të Qeverisë në të cilën bënë pjesë, për të njohur Kosovën.

Nga studentët dhe të pranishmit ministri togolez u pyet edhe për disa prej zhvillimeve kryesore politike në kontinentin afrikan, si dhe për angazhimin e mëtutjeshëm për të përhapur në Afrikë, kauzën e njohjes së Republikës së Kosovës.

Në fund të ligjëratës së tij, Ministri Dussey, u falënderua për mikpritjen e ngrohtë dhe i njoftoi studentët se nga sot mes dy vendeve mund të ketë shkëmbime në

fushën e edukimit, si rrjedhojë e marrëveshjeve të nënshkuara mes dy vendeve.

Ndërkohë drejtuesit e UBT-së e njoftuan Ministrin Robert Dussey për programet që ofron ky universitet, si dhe për të arriturat në fushën e edukimit. Ai u tregua shumë kurioz sidomos për programet në fushën e teknologjisë dhe u shpreh mjaft i impresionuar nga mirëseardhja që i kishte bërë roboti humanoid NAO. Në dalje nga UBT, ai tha se do të dëshironte që studentë nga vendi i tij të kenë mundësi për të studiuar në UBT, dhe u shpreh mjaft optimist se një gjë e tillë mund të ndodh shumë shpejt, pas marrëveshjeve të sotme.

Vizita e tij zyrtare në Prishtinë, është në kuadër të nënshkrimit të marrëdhënieve diplomatike dhe disa marrëveshjeve tjera, pas njohjes që iu bë Republikës së Kosovës nga Togo, më 2 korrik të 2014.

GJATË NJË DEBATI ME STUDENTËT E UBT-SË

MINISTRI AGANI FOLI PËR LIGJIN E SIGURIMEVE SHËNDETËSORE

Ministri Agani tha se për të ardhur deri te miratimi i këtij ligji ka pasur një rrugëtim të gjatë dhe me plot sfida, duke llogaritur edhe faktin se në të kaluarën ky ligj ishte kthyer dy herë prapa nga legjislaturat e mëhershme të Kuvendit të Kosovës

8 maj 2014 - Ministri i Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, prof. dr. Ferid Agani, zhvilloi një debat me studentët e UBT në Prishtinë, lidhur me Ligjin e Sigurimeve Shëndetësore.

Përveç studentëve dhe mysafirë tjerë ministri Agani u prit edhe nga dekani i Fakultetit të Mediave dhe Komunikimit, prof. dr. Belul Beqaj dhe drejtori për Çështje Akadematike, prof. dr. Ibrahim Krasniqi.

Ministri Agani tha se për të ardhur deri te miratimi i këtij ligji ka pasur një rrugëtim të gjatë dhe me plot sfida, duke llogaritur edhe faktin se në të kaluarën ky ligj ishte kthyer dy herë prapa nga legjislaturat e mëhershme të Kuvendit të Kosovës.

Sistemi i kaluar shëndetësor, tha ministri Agani ishte anakronik, në shpërputhje me nevojat e pacientëve dhe kërkesat e profesionistëve shëndetësor, financimi shumë i ulët për kokë banori, që gjithashtu, shoqërohej me mungesë të kapaciteteve menaxheriale.

Ministri Agani, tha se Ligji i Sigurimeve Shëndetësore që ka qëllim madhor dhe human, duke siguruar qasje universale në shërbime cilësore shëndetësore për të gjithë qytetarët, paraqet hap të madh në rrugën e reformës shëndetësore, me që ky ligj, reformon skemën e financimit të shëndetësisë.

"Shtyllat kryesore të kësaj reforme janë pesë ligjet e miratuara në Kuvendin e Kosovës: Ligji Për Shëndetësi, Ligji i Sigurimeve Shëndetësore, Ligji i Odave të Profesionistëve shëndetësor, Ligji i Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale dhe Ligji për Kontrollin e Duhanit, pa të cilat Ligji i Sigurimeve Shëndetësore nuk do ta kishte funksionimin e plotë", theksoi Ministri.

Ai shpjegoi para studentëve se këto veprime për të ndryshuar qasjen dhe për të kaluar nga një sistem i vjetër në një sistem të riorganizuar dhe me sistem decentralizues ka qenë synim i kamotshëm i tij, ngase decentralizimi i shërbimeve dhe financimit shëndetësor, sipas Ministrit, është një reformë



Rrugëtim i gjatë deri te Ligji i Sigurimeve Shëndetësore

që do të sjellë shërbime shëndetësore më të mira për qytetarët e vendit.

"Synimi i këtij ligji është që çdo qytetar i Republikës së Kosovës të ketë qasje në shërbimet shëndetësore, pa marrë parasysh se a ka paguar a jo, ngase përkundër lirimit të afër 400 000 qytetarëve nga pagesa e sigurimit shëndetësorë, shteti do të jetë ai i cili do të paguaj për ata të cilët nuk kanë mundësi ekonomike të bëjnë një gjë të tillë dhe ky veprim po bëhet në mënyrë që të ketë një fond të qëndrueshëm në ngritjen e shërbimeve shëndetësore më cilësore për popullatën e Kosovës", tha Ministri.

Në fund Ministri Agani tha se Ligji i Sigurimeve Shëndetësore është përfunduar pas negociatave të gjata mes MSh-së me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore dhe ai e quajti miratimin e këtij ligji një "fitore mbi skepticizmin ndaj Kosovës dhe kapaciteteve të saj."

Ministri i është përgjigjur edhe interesimit të studentëve për çështje të ndryshme dhe reformën shëndetësore.

PROFESORËT NGA UNIVERSITETI I PEKINIT VIZITUAN UBT-në

2 qershor 2014 – Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka pritur në një takim të veçantë profesorin e njohur kinez, prof. dr. Shiming Fan, dhe kolegun e tij, nga Universiteti i Pekinit, me të cilët bisedoi për nisjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve universitare, me qëllim të ndërlidhjes së sektorit të arsimit universitar mes të UBT-së dhe Universitetit të Pekinit.

Presidenti i UBT-së, z. Hajrizi, para mysafirëve, ka folur për zhvillimet dhe të arriturat e UBT-së dhe ka shprehur interesimin të zgjerimit të bashkëpunimit me partnerë nga Kina.

Prof. dr. Shiming Fan, dhe kolegu i tij, janë impresionuar nga faktet e treguara dhe gjetën mirëkuptimin e bashkëbiseduesit për ta nisë bashkëpunimin sa më parë.

Profesorët nga Kina, përveç takimeve dhe vizitës që i bënë UBT-së në Prishtinë, vizituan edhe disa qytete tjera në Republikën e Kosovës.



CEREMONIA E FILLIMIT TË VITIT TË RI AKADEMIK

UBT HAP DYERT PËR TË 12-tin VIT RADHAZI PËR MË TË MIRËT

Tetor 2014 - UBT me degët e saj në Prishtinë dhe Ferizaj kanë mirëpritur studentët e rinj që i janë bashkangjitur ekipit të më të mirëve.

Në një ceremoni solemne të organizuar nga stafi i UBT Prishtinë dhe UBT Ferizaj, studentët janë përshëndetur nga Rektori prof. dr Edmond Hajrizi, Drejtori për Çështje Akademike Dr. Ibrahim Krasniqi si dhe dekanët e fakulteteve përkatëse.

Në fjalimin e mbajtur para studentëve rektori Hajrizi ka theksuar rëndësinë e të qenit student i UBT-së dhe arritjeve dhe sukseseve në shtim të UBT-së që janë si rezultat i punës së palodhur të stafit të UBT dhe kontributit të vyer të studentëve.

“Përmes arritjeve tona cilësore po kontribuojmë dhe më tutje në rritjen e punësimit dhe zhvillimit të vendit në përgjithësi. Falë angazhimit të përkushtuar të stafit drejtues, akademik dhe të administratës, UBT është pranë studentëve gjatë gjithë jetës, duke i ofruar në këtë formë jo vetëm edukimin akademik adekuat, por dhe mundësi të pafund për punësimin dhe rritjen e tyre profesionale pas studimeve”, tha rektori Hajrizi.



Në fjalimin e mbajtur para studentëve të rinj rektori Hajrizi ka theksuar rëndësinë e të qenit student i UBT-së dhe arritjeve dhe sukseseve në shtim të UBT-së që janë si rezultat i punës së palodhur të stafit të UBT dhe kontributit të vyer të studentëve.

Përfaqësues të alumnit, studentë aktualë, si dhe prindërit, kanë ndarë me studentët e rinj eksperiencat e tyre me UBT. Arsimit Bytyçi, përfaqësues i prindërve të

studentëve në UBT në Ferizaj, në fjalimin para të pranishmëve ka theksuar se për të, bashkëshorten e tij dhe fëmijën e tij nuk ka qenë e vështirë zgjedhja për studimet e

larta të djalit të tij, pasi UBT bën diferencën në tregun e arsimit të lartë, duke ofruar staf profesional, infrastrukturë moderne dhe metoda të mësimdhënies bazuar

në përvojat më ekselente ndër-kombëtare si dhe mundësinë e transferimit të studimeve në një nga Universitetet partnere të UBT-së nga e gjithë bota.

UBT INAUGURON QENDRËN E RE NË PRIZREN

Numri i madh i studentëve, aktivitetet dhe projektet e shumta që UBT organizon për komunitetin, kanë krijuar domosdoshmërinë e ngritjes së një qendre akoma më të madhe të UBT-së në qytetin e Prizrenit.

Kjo qendër është pjesë e integruar e UBT Prishtinë, duke krijuar mundësinë për studentët që vijnë nga Prizreni të minimizojnë kostot, duke studiuar të njëjtat programe me kolegët e tyre në Prishtinë dhe me të njëjtit profesorë.

Duke filluar nga muaji tetor, të gjithë palët e interesuara do të kenë mundësi të informohen jo vetëm lidhur me programet e UBT por, dhe për projektet e shumta në qendrën e UBT tashmë dhe në Prizren.

Rektori i UBT-së së bashku me një pjesë të stafit akademik dhe administrativ ka inauguruar qendrën e re në Prizren. Në inaugurimin e kësaj qendre rektori i UBT-së prof.dr Edmond Hajrizi iu drejtua të pranishmëve duke venë theksin tek fakti se “UBT me anë të kësaj qendre do të jetë gjithmonë e më pranë regjionit të Prizrenit, jo vetëm në ofrimin e studimeve të larta, por dhe me trajnime, projekte, këshilla profesionale, analiza të zhvillimit ekonomik, ndërmarrësi të reja etj.”

Prezent në këtë ceremoni kanë qenë dhe përfaqësues të pushtetit lokal si nënkryetari i Komunës, z.Lulzim Kabashi, kryetari i Shoqatës së Zëjtarëve, z.EdizÇabrati, si dhe shumë përfaqësues të bizneseve, organizatave të ndryshme ndërkombëtare si dhe organizatave joqeveritare, pasi qendra e UBT në Prizren është një vlerë për Prizrenin e përmes kësaj qendre misioni i UBT është të punoj në zhvillimin edukimit, por edhe të punësimit dhe zhvillimin ekonomik të Prizrenit dhe të regjionit.



NGA AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM

UBT-së I AKREDITOHEN PROGRAME TË REJA INOVATIVE DHE I RIAKREDITOHEN PËR PESË VITE

Prishtinë, 3 korrik 2014- UBT është i vetmi Institucion i arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës që sjell programe studimi të veçanta në vend dhe në rajon, programe të kërkuara në tregun e punës

Pas shpalljes së rezultateve të procesit të akreditimit dhe riakreditimit nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), në UBT studiohet në këto programet të gjithsej të akredituara si:

Menaxhment, Biznesi dhe Ekonomi (Bachelor dhe Master)

me mundësi specializimi në: Financa, Banka dhe Kontabilitet,

Marketing dhe Shitje, Menaxhment dhe Ndërmarrësi,

Logjistika dhe Menaxhimi i Prokurimit.

Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri (Bachelor dhe Master), me mundësi specializimi në:

Rrjeta dhe Telekomunikacion, Inxhinieri te Softuerit dhe Sistemeve,

Bazat e të dhënave dhe Sistemet e informacionit, Dizajn dhe Multimedia, dhe Mekatronikë dhe Robotikë.

Menaxhment i Mekatronikës (Bachelor dhe Master)

(Elektroteknika, Elektronika, Teknologjia e Informacionit, Prodhimtaria Industriale, Ndërmarrësi dhe Menaxhment)



Arkitekturë dhe Planifikimi

Hapësinorë (Bachelor dhe Master)

Juridik (Bachelor - LLB)

Sistemet Informacionit (Bachelor dhe Master)

Inxhinieri të Ndërtimit dhe

Infrastrukturë (Bachelor)

Shkencat Politike (Bachelor -

BA

Me mundësi specializimi në:

Marrëdhënie Ndërkombëtare

dhe Diplomaci,

Integrime Evropiane,

Administratë Publike.

Media dhe Komunikim (Bachelor -

BA)

Politika Publike dhe Menaxhimi

(Master)

Përveç programeve të cekura

më lartë përmes UBT ofrohen stu-

dime, diplomim dhe bursa në disa

universitet prestigjioze në Evropë:

- Master i Shkencave (M.Sc.) në

‘EngineeringManagement’ nga

Universiteti i Vjenës për Teknolo-

gjji (Austri)

- Master në Menaxhimi e

Biznesit (MBA) nga DanubeUni-

versityKrems (Austri), në mun-

dësi të specializimit në disa fusha.

- Bachelor dhe MasterofArts

(BA, MA) në Studimet Ndër-

kombëtare nga Universiteti i

Varshaves (Poloni)

- Bachelor dhe MasterofS-

cience (BSc, Msc) nëCompu-

terScienceandEngineering nga

CityUniversityLondon (Britani e

Madhe)

- Master i Arteve (M. A.) në

Integrime dhe të Drejtën Evro-

piane nga Institute për Studime

Evropiane dhe Ndërkombëtare

- CIFE (Francë)

- Master në Menaxhimi e

Biznesit (MBA) nga DanubeUni-

versityKrems (Austri), në mun-

dësi të specializimit në disa fusha.

- MasterofScience (M. Sc.) në

Sistemet e Informacionit në

Waterfor Institute ofTechnology

(Irlandë).

VIZITË NË TIRANË E STUDENTËVE TË FAKULTETIT TË MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT, SHKENCAVE POLITIKE DHE TË JURIDIKUT



"Një takim shumë miqësor me studentë të UBT, Prishtinë. Bashkëbisedim i hapur me përfaqësues nga Fakulteti i Shkencave Politike, Fakulteti i Medias dhe Komunikimit si dhe Fakulteti Juridik, nën shoqërimin e dekanit, prof. dr. Belul Beqaj", shkroi Presidenti Nishani në Facebook

STUDENTËT E UBT-SË VIZITUAN SHQIPËRINË, TAKUAN PRESIDENTIN NISHANI

Presidenti Nishani në rrjetin e tij social në facebook, ka postuar foto të realizuara bashkë me studentë ku komenton: "Një takim shumë miqësor me studentë të UBT, Prishtinë. Bashkëbisedim i hapur me përfaqësues nga Fakulteti i Shkencave Politike, Fakulteti i Medias dhe Komunikimit si dhe Fakulteti Juridik, nën shoqërimin e dekanit, prof. dr. Belul Beqaj"

26 maj 2013- Mbi 45 studentë të Fakultetit të Medias dhe Komunikimit, Shkencave Politike dhe të Juridikut në UBT organizuan vizitë katërditore në Republikën e Shqipërisë. Këtij organizmi studimor, përveç studentëve iu bashkëngjiten edhe disa nga anëtarët e stafit akademik të këtyre fakulteteve.

Studentët vizituan Presidencën e këtij vendi, ku pritën nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, i cili mbajti një fjalim para studentëve për zhvillimet aktuale dhe nevojën e rinisë dhe politikës që t'i kushtojë më shumë vëmendje krijimit të kushteve për të ardhmen e përbashkët.

Dekani, Belul Beqaj, falënderoi Presidentin Nishani, në emër të studentëve dhe Presidentit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

Presidenti Nishani në rrjetin e tij social në facebook, ka postuar foto të realizuara bashkë me studentë ku komenton: "Një takim shumë miqësor me studentë të UBT, Prishtinë. Bashkëbisedim i hapur me përfaqësues nga

Fakulteti i Shkencave Politike, Fakulteti i Medias dhe Komunikimit si dhe Fakulteti Juridik, nën shoqërimin e dekanit, prof. dr. Belul Beqaj".

Gjatë të njëjtës ditë studentët kishin vizituar edhe sallën e seancave plenare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Përveç ambienteve të brendshme, ata patën mundësi të njihen edhe me rolin dhe funksionet e pozicioneve kryesore politike dhe administrative të Kuvendit, si dhe të bëjnë dallimet e praktikës parlamentare të Shqipërisë me atë të Kosovës.

Ditën në vijim studentët u pritën në Ambasadën e Kosovës në Republikën e Shqipërisë nga i ngarkuari me punë dhe zëvendësambasadori, z. Gani Veselaj, i cili foli për rolin e ambasadave në politikën e jashtme të Kosovës, rëndësinë e veçantë që ka Ambasada e Kosovës në Tiranë në këtë fushë, si dhe për strukturën e brendshme organizative të ambasadës.

Vizitat vazhduan në TV Klan dhe ABC News, ku kryeredaktorët

dhe gazetarët kishin organizuar ture për grupet e studentëve, që vizituan pjesën më të madhe të sallave të lajmeve dhe emisioneve të këtyre televizioneve, si dhe patën mundësi të bashkëbisedojnë e të shkëmbejnë eksperiencën me punonjësit e tyre. Vizituan edhe disa institucione universitare.

Qëllimi i kësaj vizite bazohej në përfundim të informacioneve dhe njohurive dalluese karshi institucioneve homonime dhe medias që ka Kosova në raport me Shqipërinë.

"Vizituam disa institucione dhe i pamë nga afër se si zhvillohej puna e ekipore në to, ngjashmëritë e dallimet nga Kuvendi i Kosovës. Më pastaj Presidenti Bujar Nishani na tregoi sfidat dhe sukseset në fushën e edukimit, arsimit. Por vendi që më ngjalli më shumë interesim ishte TV Klan, shikova se si realizohet lajmet drejtpërdrejt, si shkon procedura deri në publikimin apo transmetimin e lajmit. Eksperiencë e paharruar që na ofroi Universiteti gjigand i diturisë UBT", tha studentja Albina Zeneli.

STUDENTËT E MEDIAS NË UBT VIZITOJNË AMBIENTET E RTV 21



Prishtinë - Studentët e medias në UBT, në kuadër të aktiviteteve të tyre studimore, kanë realizuar një vizitë në ambientet e RTV 21. Studentët janë ndarë të kënaqur nga përvoja që kanë fituar rreth punës që bëjnë këto dy medime.

Studentët e medias në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) të shoqëruar nga profesori Musa Sabedini kanë realizuar vizita profesionale për të parë pjesën praktike në RTV 21.

Studentët në ambientet e RTV21 janë pritur nga Esad Dujaka redaktor në këtë medium i cili u ka shpjeguar studentëve tërë procedurën rreth mbledhjes së lajmeve, përgatitjes së tyre deri tek ana finale.

Dujaka u tha studentëve se gazetaria është një profesion shumë i dashur, por që kërkon përkushtim, guxim dhe profesionalizëm. Studentët e vitit të parë ndërkaq kanë shtruar pyetje të ndryshme që lidhen me punën e ekipore që bëhet para ekraneve dhe kamerave televizive.

STUDENTËT E UBT-SË PËRFITOJNË NJOHURI EDHE NGA GAZETA "ZËRI"

Prishtinë - Edhe në ambientet e gazetës "Zëri" studentët janë pritur nga Arbana Xharra kryeredaktore dhe Milaim Shefkiu redaktor. Xharra u ka folur studentëve për konceptin e gazetës, derisa ka shtuar se gazetaria hulumtuese dhe temat kundër krimit, korrupsionit janë prioritet i kësaj gazete.

Studentët janë njohur edhe me ecurinë e punës së gazetës që nga fillimi e deri në finale. Studentët ndërkaq kanë bërë pyetje të shumta rreth anës profesionale që zhvillojnë këto dy medime.

Studentja Edita Bujupaj tha se është ndarë e kënaqur nga vizita në këto dy medime. "Vërtet për mua ishte një befasi e këndshme sepse pash drejtpërdrejtë tërë procedurën e realizimit të lajmeve dhe u njoha edhe me punën që bëjnë gazetaret. Tani po bindem se ia ka vlejtur që të jem pjesë e UBT-së".

Edona Jerliu studente tha se praktika nëpër medime është shumë e dobishme për ta. "Kjo na ndihmon shumë sepse në radhë të parë e njohim punën praktike dhe mësojmë edhe nga përvoja e gazetarëve profesionist".



Studentët e vitit të parë të drejtimit Media dhe Komunikim gjatë vizitës në gazetën "Zëri"

AKTIVITETE TË STUDENTËVE TË UBT-SË

STUDENTËT E ARKITEKTURËS NË VIZITË STUDIMORE NË STAMBOLL

Ata vizituan dhe organizuan ligjërata të përbashkëta nëpër universitete të ndryshme me të cilat UBT ka marrëveshje bashkëpunimi ndëruniversitar, si në Universitetin "MimarSinan", në Universitetin "Kadir Has" e të tjerë

15 maj 2013 – Më shumë se 60 studentë, si dhe mësimdhënës të Fakultetit të Arkitekturës në UBT organizuan vizitë njëjavore në Stamboll të Turqisë.

Ata kanë vizituar Panairin Ndërkombëtar të Materialeve, Muzeun Modern të Stambollit, Muzeun Arkeologjik, Milenium Shopping Center (Akvarium). Ata gjithashtu vizituan dhe organizuan ligjërata të përbashkëta nëpër universitete të ndryshme me të cilat UBT ka marrëveshje bashkëpunimi ndëruniversitar, si në Universitetin "MimarSinan", në Universitetin "Kadir Has" e të tjerë.

Ata gjithashtu përcollën edhe uorkshopin ndërkombëtar me studentët e Universitetit "MimarSinan", nga fusha e urbanizmit, i cili u përmbyll me prezantimet e studentëve dhe me ndarjen e certifikatave të pjesëmarrjes.

Studentët tanë ndoqën ligjërata të profesorëve e këtyre universiteteve të shtetit turk, dhe një ligjëratë nga dekan i Fakultetit të Arkitekturës në UBT, dr. Binak Beqaj, me temën "Transformimi urban i qyteteve në vendet e Evropës Juglindore".



Studentët e Arkitekturës gjatë vizitës në Stamboll

UBT AKREDITOHET DHE PËR PROGRAME TË ARSIMIT PROFESIONAL

EDHE DY PROGRAME TË REJA NË UBT: INXHINIERI E ENERGISË DHE INXHINIERI E ENERGISË EFIÇIENTE

Këto programe do të funksionojnë dhe me anë të mbështetjeve financiare të programit të Komisionit EuropeanTempus. Përmes këtij programi UBT ka ngritur qendrën e ekspertizës dhe laboratorë modernë për Energjinë

Me vendimin 1123/14, të datës 07.11.2014, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka akredituar dy programe të reja në UBT: Inxhinieri e Energjisë, program në nivelin bachelor, si dhe programin profesional dyvjeçar Inxhinieri e Energjisë Eficiente. Këto programe do të ofrohen për herë të parë në Kosovë.

Këto programe do të funksionojnë dhe me anë të mbështetjeve financiare të programit të Komisionit EuropeanTempus. Përmes këtij programi UBT ka ngritur qendrën e ekspertizës dhe laboratorë modernë për Energjinë.

Njëkohësisht, përmes projektit TEMPUS janë iniciuar dhe një numër i konsiderueshëm iniciativash të tjera dhe studentët e UBT -së do kenë mundësi të kenë në stafin e profesorëve dhe një numër të konsiderueshëm të profesorëve ndërkombëtar.

UBT gjithashtu ka ndërtuar dhe kampusin e vetëm të inovacionit dhe teknologjisë në Kosovë që është njëkohësisht është tashmë anëtar i IASP- rrjetit mbarëbotëror të parqeve shkencore dhe të fushave të inovacionit. Misioni kryesor i anëtarëve të IASP është të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik kombëtar dhe botëror ndërmjet inovacionit, ndërmarrësisë dhe transferimit të dijes dhe teknologjisë.

TAKIME

PRESIDENTI HAJRIZI PRITI EKSPERTIN HOLANDEZ TË TURIZMIT, BERT HOFMA

30 maj 2014 – Eksperti i shquar ndërkombëtar nga fusha e turizmit, Bert Hofma vizitoi UBT-në, ku u prit nga presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

Z. Hofma dhe z. Hajrizi zhvilluan edhe disa takime të rëndësishme me zyrtarë të lartë të institucioneve të Republikës së Kosovës, përfshirë takimet me zyrtarë të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimit, të Agjencinë Kosovare të Akreditimit, dhe me ekspertë nga fusha e turizmit.

UBT ka në vazhdimësi bashkëpunim me shtetin holandez. Kështu, para pak ditësh, ambasadori i Holandës në Republikën e Kosovës, Robert Bosch, ishte i pranishëm në UBT, dhe para profesorëve, studentëve dhe mysafirëve të tjerë, mbajti një ligjëratë për procesin e integritimit në Bashkimin Evropian.

UBT ZGJERON RRJETIN E BASHKËPUNIMIT

UNIVERSITETI I PESCI SHTOHET LISTËS SË UNIVERSITETEVE PARTNERE TË UBT



Tashmë UBT ka shtuar në listën e Universiteteve Partnere Ndërkombëtare dhe Universitetin e Pesc në Hungari. Të dyja institucionet kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi që konsiston në shkëmbimin e profesorëve, studentëve si dhe hartimin e programeve të përbashkëta

akademike, kërkimore si dhe kulturore.

Stafi akademik i UBT-së do të ketë mundësi të shkëmbejë eksperinca me stafin akademik të Universitetit të Pesc në fushën e metodologjive të mësimdhënies, metodave kërkimore etj

Katër anëtarë të stafit të UBT-së, pjesë e Fakultetit të Arkitekturës në UBT janë regjistruar për studime të doktoratës në Universitetin Pesc në Hungari.

Kandidatët e regjistruar janë: Mimoza Sylejmani, Petrit Ahmeti, Ferhat Bejtullahu dhe Besa Jagxhiu.

Gjithashtu të dyja institucionet do të mund të shkëmbejnë studentët për programe të caktuara studimore.

Në kuadër të kësaj marrëveshje, të dyja institucionet do të kenë mundësi të hartojnë programe të përbashkëta studimi si dhe të aplikojnë për grante në fushën e edukimit dhe kërkimeve shkencore.

AKTIVITETE

UBT BASHKORGANIZATORE E KONFERENCËS SË PESTË NDËRKOMBËTARE NË TIRANË



Konferenca dyditore shkencore në nivel ndërkombëtar me temën "Sistemet e Informacionit dhe Teknologjitë inovative drejt një ekonomie digjitale"

12 qershor 2014- Departamenti Matematikë, Statistikë dhe Informatikë në kuadër të Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës (UT), për herë të pestë organizoi konferencën dyditore shkencore në nivel ndërkombëtar me temën "Sistemet e Informacionit dhe Teknologjitë inovative drejt një ekonomie digjitale". Konferenca u organizua nën patronazhin e Akademisë të Shkencave të Shqipërisë, dhe me bashkorganizim të UBT-së, dhe u mbajt në kryeqendrën e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.

Përveç krerëve të të tri institucioneve organizatore, si presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, rektori i Universitetit të Tiranës (UT), Dhori Kule, dhe kryetar i Akademisë së Shkencave (ASHK), GudarBeqiraj, në hapjen solemne morën pjesë edhe përfaqësues të lartë të Republikës së Shqipërisë, ministrja për Inovacionin dhe Administratën Publike, znj. Milena Harito, etj.

Duke përshëndetur konferencën, dr. Hajrizi vlerësoi lart bashkëpunimin midis institucioneve shkencore të të dyja shteteve, bashkëpunimi i cili duhet të intensifikohet edhe më tej, në mënyrë që të shkëmbehen përvojat dhe të arrihen rezultate edhe më të mëdha në hulumtimet dhe inovacionet shkencore, në mënyrë që studentët dhe ekspertët shqiptarë nga të dy shtetet të ecin krahas kolegëve të tyre nga shtetet më të zhvilluara botërore në fushën e ekonomisë dhe teknologjisë.

Kurse prof. dr. Kozeta Sevrani, organizatore e Konferencës dhe përgjegjëse e Departamentit Matematikë, Statistikë dhe Informatikë e Zbatuar në UT, përveç që i përshëndeti të pranishmit falënderoi edhe partnerët dhe sponsorët e kësaj konference, akterë të njohur të tregut shqiptar, të cilët me dashamirësinë e tyre ofruan mbështetjen e tyre për zhvillimin e kësaj konference.

Ministrja Harito përveç tjerave foli për projektet e MIAP dhe Qeverisë, u ndal në një projekt madhor si ai i reformës së shërbimeve publike, duke i bazuar ato në dixhitalizim dhe inovacion, dhe shpjegoi se ky projekt është një reformë e rëndësishme ligjore dhe strukturore e funksionimit të administratës.

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, udhëhoqi edhe sesionin "Emerging Technologies", si dhe prezantoi dy punime shkencore.

Për dy ditë më radhë në konferencë u mblodhën një numër i madh i pedagogëve, studiuesve dhe ndërmarrjeve të fushës së dhe IT-së nga shumë vende të rajonit dhe Evropës. Janë paraqitur mbi 170 punime shkencore, dhe u kumtuuan në disa sesione paralele gjë që i dha konferencës një karakter shumë të rëndësishëm me peshë shkencore. Paraqitësit e kumtesave, përveç nga Shqipëria dhe Kosova, ishin edhe nga shtete e shumta të Evropës.

AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE

IPC MERR PJESË NË VLERËSIMIN E KOMPETENCËS PËR MENAXHIMIN E PROJEKTEVE NË GJERMANI

Pjesë e ekipit ku z. Hajrizi është përfaqësues janë dhe prof. Roessler, Lead Assesor dhe prof. Seilier, ky i fundit në cilësinë e vlerësuesit ndërkombëtar të IPMA në Kosovë

Prishtinë, 7 maj 2014 - Organizata Gjermane për Menaxhimin e Projekteve GPM-PMZert, e cila është pjesë e Organizatës Botërore për Menaxhimin e Projekteve (IPMA), ka ftuar presidentin e UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, të jetë pjesë e punëtorisë dhe grupit vlerësues për menaxherët e projekteve për nivelet C dhe B, për kompaninë ZEISS, në Aalen të Republikës së Gjermanisë.

Republika e Kosovës përfaqësohet në IPMA nga Kosova Association for Management – International Professional Evaluation & Certification (KAM-IPC).

Kjo vizitë u realizua në kuadër të bashkëpunimit GPM dhe KAM dhe ka si qëllim ndarjen e përvojave më të mira në certifikim dhe në arritjen e niveleve më të mëdha të kompetencës edhe në Republikën e Kosovës. Për herë të parë në Kosovë këto certifikime do të mundësohen nga International Professional Evaluation & Certification (IPC).

Prof. dr. Edmond Hajrizi, është vlerësuesi i parë në Kosovë i IPMA për menaxhimin e projekteve në Kosovë, dhe në gjithë trevat shqip folëse, dhe njëkohësisht drejtues i IPC.

Pjesë e ekipit ku z. Hajrizi është përfaqësues janë dhe prof.



Për herë të parë në Kosovë këto certifikime do të mundësohen nga International Professional Evaluation & Certification (IPC)

Roessler, Lead Assesor dhe prof. Seilier, ky i fundit në cilësinë e vlerësuesit ndërkombëtar të IPMA në Kosovë.

IPC, falë bashkëpunimit me GPM, përdor standardet dhe procesin gjerman në Kosovë. Më konkretisht GPM është njëra prej

organizatave më profesionale për menaxhimin e projekteve më të mëdha dhe të respektuara në botë.

REKTORI I UBT-SË QËNDROI PËR VIZITË NË GJERMANI

PRESIDENTI I UBT-SË VIZITOI UNIVERSITETIN OFFENBURGUT DHE DISA KOMPANI DHE INSTITUTE GJERMANE

“Me këtë rast fokusi i bashkëpunimit ishte në fushën e energjisë, teknologjisë më moderne (medicinale, robotikë, mekatronikës, proceseve përfituese të produkteve nga natyra), përpunimit të metaleve, saldimit, bashkëpunimit me industrinë, projektet hulumtuese në nivelin evropian “Horizon 2020”, si dhe proceseve për përfitimin e biogasisit si dhe produkteve të tjera me rendësi”, ka thënë presidenti i UBT-së, z. Hajrizi, pas takimit që pati me z. Isele

Maj 2014 - Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka vizituar Universitetin e Offenburgut, ku u prit nga dekani i këtij Universiteti, prof. dr. Alfred Isele.

Në këtë vizitë, z. Hajrizi është njoftuar më për së afërmi me zhvillimin e Universitetit të Offenburgut, me theks të veçantë rreth infrastrukturës. Gjithashtu, ata biseduan më gjerësisht për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

“Me këtë rast fokusi i bashkëpunimit ishte në fushën e energjisë, teknologjisë më moderne (medicinale, robotikë, mekatronikës, proceseve përfituese të produkteve nga natyra), përpunimit të metaleve, saldimit, bashkëpunimit me industrinë, projektet hulumtuese në nivelin evropian “Horizon 2020”, si dhe proceseve për përfitimin e biogasisit si dhe produkteve të tjera me rendësi”, ka thënë presidenti i UBT-së, z. Hajrizi, pas takimit që pati me z. Isele.

Bisedat rreth fillimit të bashkëpunimit ndëruniversitar kanë nisur edhe më herët, me ç’rast dekani i Universitetit të Offenburgut, prof. dr. Alfred Isele, ka vizituar UBT-në, dhe është biseduar për të vazhduar bashkëpunimit mes UBT dhe Universitetin Offenburgut.

Gjithashtu, Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë qëndrimit në Republikën e Gjermanisë,



Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë qëndrimit në Republikën e Gjermanisë, ka vizituar edhe kompani të njohura të njohura të regjionale, institute për energji, dhe institucione të tjera të rëndësishme, i shoqëruar nga dekani i Universitetit të Offenburgut, prof. dr. Alfred Isele

manisë, ka vizituar edhe kompani të njohura të regjionale, institute për energji, dhe institucione të tjera të rëndësishme, i shoqëruar nga dekani i Universitetit të Offenburgut, prof. dr. Alfred Isele.

Me prof. Isele, përveç që u bisedua gjerësisht për vazhdimin e bashkëpunimit ndëruniversitar, ata biseduan edhe për mundësinë e zhvillimit të një projekti më konkret ndërmjet këtyre dy institucioneve të arsimit të lartë, duke përfshirë dhe industrinë nga të dyja vendet. “UBT është duke punuar në një projekt pilot për të sjellë industrinë në Kamposin e UBT-së, për t’ju mundësuar studentëve të këtij institucioni punësimin në të, dhe për t’u njohur me zhvillimet më të reja në industri. Njëkohësisht ky projekt është dhe një ndihmë të stafit akademik të UBT-së duke u dhënë mundësinë të zhvillo-

jnë hulumtimet e tyre konform industrisë, direkt në kampus”, tha z. Hajrizi.

Z. Hajrizi, i shoqëruar nga prof. Isele, vizituan edhe kompaninë “Herrenknecht”, ku u pritën nga udhëheqësi i sektorit të zhvillimit, dr. Marc Peters, i cili ua prezantoi strategjinë e kësaj kompanie, fushat e interesit, sektorin e prodhimit të pajisjeve dhe shkollën profesionale që operon në kuadër të kësaj kompanie.

Po ashtu edhe dr. Peters, shprehu interesin e kompanisë “Herrenknecht” për të qenë aktive në rajon, por edhe për të bashkëpunuar me kompanitë kosovare për të liferuar produkte të gatshme dhe cilësore.

Në kuadër të kësaj, dr. Marc Peters, shprehu gatishmërinë për t’i mundësuar studentëve të UBT-së praktikën në këtë kompani, e cila prodhon pajisje për shpimin dhe



ndërtimin e tuneleve/kanaleve nëntokësore. Është bërë me dije se 70 për qind e tuneleve në të gjithë botën ndërtohen nga kjo kompani, e cila është themeluar para 35 viteve.

Po ashtu, z. Hajrizi, duke pasur parasysh faktin se UBT ka ftuar projektin “TEMPUS”, për krijimin e një qendre kompetente për energji eficientë dhe në kuadër të Universitetit të Offenburgut, vizitoi edhe Institutin për Energji, dhe në përgjithësi laboratorët e këtij Instituti. Ai u prit nga prof. Bhol, si dhe me bashkëpunëtorët e tij, me të cilët bisedoi për mundësitë për ta rritur eficientësinë për ndërtimin e qendrës së UBT-së. Z. Hajrizi iu prezantuan dhe prototipet, të cilat po i zhvillon ky universitet, si dhe sukseset që janë arritur në këtë drejtim.

Njëkohësisht Hajrizi u foli kolegëve të Offenburgut për zhvillimet

e fundit të UBT. “Me bashkëpunëtorët e kësaj pjese u theksua rëndësia që ka për Kosovën zhvillimi i kompetencës në fushat bazike të industrisë, siç është përpunimi i metalit, testimi i materialeve, si dhe teknologjia e saldimit”, tha z. Hajrizi.

Ai shtoi se ekspertët e këtij institucioni shprehën gatishmërinë për të ndihmuar në këtë drejtim. Kjo ishte një përvojë shumë e mire dhe në kohë, duke marrë parasysh se UBT ka planifikuar se gjatë këtij viti ta ndërtojë një laborator modern në fushën e materialeve, përpunimit të metaleve dhe saldimit, - tha z. Hajrizi.

Rektori i UBT, prof. dr. Edmond Hajrizi, është ndalur edhe në Karlsruhe, për ta vizituar për së afërmi dhe universitetin e njohur të këtij qyteti “Karlsruhe Institute of Technology”.

CEREMONI MADHËSHTORE NË KAMPUSIN E RI UNIVERSITAR TË UBT-SË

U ZHVILLUA CEREMONIA E DIPLOMIMIT 2014

Në këtë ceremoni studimet bachelor dhe master i përmbyllën mbi 350 studentë të Fakulteteve: nga dyja nivelet e studimit Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Fakulteti për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Fakulteti për Makronikë, kurse Fakulteti për Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor ai Juridikut dhe Sistemet e Informacionit të nivelit bachelor

5 korrik 2014- Në një ceremoni madhështore, organizuar në Kampusin e ri universitar të UBT-së, u zhvillua Ceremonia e Diplomimit 2014, në të cilën studimet bachelor dhe master i përmbyllën mbi 350 studentë të Fakulteteve: nga dyja nivelet e studimit Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Fakulteti për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Fakulteti për Makronikë, kurse Fakulteti për Arkitekturë dhe Planifikim Hapë-



Të pranishëm në këtë ceremoni madhështore ishin prindër dhe familjarë, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare, përfaqësues të ambasadave të akredituara më zyre në Prishtinë, dekanët e fakulteteve, profesorë dhe studentë të UBT-së dhe të dhe të ftuar të tjerë

sinor ai Juridikut dhe Sistemet e Informacionit të nivelit bachelor.

Të pranishëm në këtë ceremoni madhështore ishin prindër dhe familjarë, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare, përfaqësues të ambasadave të akredituara më zyre në Prishtinë,

dekanët e fakulteteve, profesorë dhe studentë të UBT-së dhe të dhe të ftuar të tjerë.

Me nga një fjalë rasti ceremoninë e kanë përshëndetur presidentit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, dhe disa profesorë ndërkombëtarë si Andreas Dalluege, ndërsa në emër

të Alumni të UBT-së, Përparim Muja.

Pas fjalëve përshëndetëse ka vijuar ceremonia e diplomimit, me dhënien e betimit nga të porsadiplomuariat dhe me marrjen e certifikatave.

Po kështu, gjatë kësaj ceremonie janë shpallur edhe studen-

tët e dalluar të të Fakulteteve të cekura si më lartë, të cilët janë nderuar me certifikata.

Manifestimi është përcjellë me pika të zgjedhura muzikore, ndërsa madhështinë atij ia kanë shtuar mysafirët e shumtë, të cilët kanë madhështuar ceremoninë e diplomimit.

AKTIVITETI TRADICIONAL I UBT-SË

AKADEMIA VERORE NDËRKOMBËTARE

3 korrik-4 gusht 2014 - UBT në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha departamentet, stafin akademik dhe ekspertët të shumët, ka organizuar aktivitetin e vet tradicional "Akademisë Verore 2014", i cili është aktivitet unik dhe atë në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Para shumë të pranishmëve si studentë e profesorë të UBT-së, ekspertë nga fusha e arkitekturës dhe mysafirë tjerë, Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor bënë hapjen solemne të punimeve.

"Ky aktivitet ka për qëllim që pjesëmarrësve t'ju ofrojë një program që do t'ju mundësojë njohuri të reja të përzgjedhura nga shume fusha tematike që nuk janë pjesë e programit të studimeve të rregullta", tha dekan i Fakulteti të Arkitekturës, dr. BinakBeqaj.

"Është hera e tretë që në organizojmë këtë aktivitet, me qëllim që edhe gjatë kohë së verës të jemi aktivë. Përveç ligjëratave dhe elementeve të tjera që e përcjellin studentin gjatë studimeve, semestrave të caktuar, ne kemi bërë edhe këtë aktivitet, vetëm që studentit të ketë njohuri edhe më shumë për fushat e caktuara. Gjithashtu, temat që ligjërohen dhe puna që do të bëhet në këtë Akademi, thuaja kanë ndërlidhje të dukshme me fushat tjera të cilat studiohen në UBT, p.sh. energjinë efiçiente, ku UBT do të jetë aktive edhe në këtë vit, sepse kemi një projekt të Komisionit Evropian,

për të ndërtuar Qendrën Efiçente brenda UBT-së", tha presidenti i UBT-së prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë hapjes solemne të "Akademisë Verore 2014".

Ndërsa drejtori i Departamentit të Shkencës në MASHT, MurtezaOsdautaj, lavdëroi punën që po behët në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, po ashtu punën dhe studimet që zhvillohen në përgjithësi në UBT, duke theksuar se këto suksese ndërlidhen me zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

Ndërkaq drejtori i Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Prishtinës, LiburnAliu, tha se ne si komunë jemi të përkushtuar t'i ndihmojmë dhe t'i përkrahim të gjithë studentët kosovarë, duke bashkëpunuar edhe me studentët të universiteteve të jashtme, për ndryshime për të mirën e këtij vendi.

Po ashtu këtë aktivitet e ka përshëndetur edhe drejtori për Çështje Akadematike në UBT, prof. dr. Ibrahim Krasniqi.

Akademia Verore Ndërkombëtare e UBT-së ka zhvilluar punimet për një muaj rresht. Në këtë edicion ishin pjesëmarrës një numër i madh studentësh, jo vetëm të nëntë fakulteteve të UBT-së, por edhe të universiteteve të jashtme ndërkombëtare si dhe të tjera vendore, dhe ligjëruan një varg i profesorëve tanë dhe të huaj dhe ekspertë të temave e caktuara.



Akademia Verore Ndërkombëtare e UBT-së ka zhvilluar punimet për një muaj rresht. Në këtë edicion ishin pjesëmarrës një numër i madh studentësh, jo vetëm të nëntë fakulteteve të UBT-së, por edhe të universiteteve të jashtme ndërkombëtare si dhe të tjera vendore, dhe ligjëruan një varg i profesorëve tanë dhe të huaj dhe ekspertë të temave e caktuara

Sipas organizatorit të këtij aktiviteti prof. dr. Edmond Hajrizi, dhe drejtuesve të fakulteteve në UBT, të gjithë pjesëmarrësit gjatë këtyre ligjëratave kanë përfituar njohuri të ndryshme dhe të shumta dhe kanë pasur mundësi të shkëmbejnë eksperiencën.

Përveç ligjëruarëve të shumtë, si vendorë ashtu edhe ndërkombëtarë që kanë ligjëruar nëpër fakultete përkatëse, akademinë e kanë përshëndetur edhe disa mysafirë të cilët ishin të pranishëm në ceremoninë e nisjes së aktivitetit për fakultetet përkatës si profesori nga Austria, prof. EngelbertSelenko, ministri

i Tregtisë dhe Industrisë, BernardNikaj, kryetari i Komunës së Shtimes, mr. sc. Naim Ismajli, drejtori i Departamentit të Shkencës në MASHT, MurtezaOsdautaj, drejtori i Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Prishtinës, drejtoresha e STIKK-ut, Vjollca Çavolli, Mehmet Gjata, kryeredaktor në revistën "Ekonomia", etj.

Për dallim prej fakulteteve të tjera, Fakulteti i Shkencave Politike dhe ai i Juridikut, aktivitetin në fjalë e kanë organizuar në bashkëpunim me "Friedrich Ebert Stiftung", në Prishtinë.

Secili fakultet i ka zhvilluar punimet në disa sesione, gjatë të cilave u dhanë disa ligjëratë në interes të pjesëmarrësve.

Ky aktivitet është financuar nga UBT-ja dhe punimet e tij u ndoqën gjatë muajit korrik dhe gusht 2014, paralelisht në të gjitha fakultetet. Përveç të tjerave, këtu u përfshinë udhëtime të ndryshme në terren, me ç'rast u vizituan edhe objekte, disa nga kompanitë dhe institucionet më të suksesshme në tregun e Kosovës, dhe në fund të punimeve pjesëmarrësit u pajisën me certifikata.

UBT PËRUIROI QENDRËN E KOMPETENCËS INOVATIVE PËR MODELIM DHE SIMULIM

Edmond Hajrizi ka thënë se UBT-ja është një institucion modern dhe inovativ në Republikën e Kosovë, që i ka përparësitë e institucioneve të njohura ndërkombëtare, ngase jo vetëm që ofron programe të një cilësie të lartë studimesh, dhe institute, por tash e tutje e ka edhe Qendrën e Kompetencës Inovative për Modelim dhe Simulim, që mbështetë çdo fakultet që merret me simulim, modelim dhe optimizim

5 qershor 2014 - Në UBT u bë përfundimi i Qendrës së Kompetencës Inovative për Modelim dhe Simulim, me ç'rast fjalimin hyrës inaugurues, para të pranishmeve e ka mbajtur presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, dhe më pas profesorët e nga Universiteti Teknik i Vjenës, dhe nga universitete të tjera partnere.

Nga folësit kjo qendër u cilësua e rëndësishme së veçantë dhe me një koncept të ri, si një urë bashkëpunimi ndërinstitucional, dhe për t'i ndihmuar vendit tonë që dhe rajonit e më gjerë.

Duke folur para të pranishmëve, përfaqësuesve të institucioneve të Republikës së Kosovës, atyre ndërkombëtare, përfaqësuesve të medieve, profesorëve dhe studentëve të UBT-së dhe të ftuarve të tjerë, presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka thënë se UBT-ja është një institucion modern dhe inovativ në Republikën e Kosovë, që i ka përparësitë e institucioneve të njohura ndërkombëtare, ngase

jo vetëm që ofron programe të një cilësie të lartë studimesh, dhe institute, por tash e tutje e ka edhe Qendrën e Kompetencës Inovative për Modelim dhe Simulim, që mbështetë çdo fakultet që merret me simulim, modelim dhe optimizim.

Dr. Hajrizi më tej ka shtuar se është qendër e veçantë, dhe qendër tash e tutje mund të bashkëpunojë edhe me qendrën "UBT STATS", e cila merret me mbledhjen, organizimin dhe publikimin e të dhënave statistikore.

"UBT SIM" do të jetë simulimi i modeleve, vizualizimi, parashikimi dhe optimizimi i vendimmarrjes. Këto lloj kërkimesh do të çojnë në më shumë publikime. Krijimi i modeleve për shpjegimin e problemeve dhe fenomeneve që shohim sot në shoqëri, për shembull "health care", nuk e dimë sa kushton, si zhvillohet procesi, çmimi i barnave, po ashtu çështja e burimeve, nuk e dimë si po menaxhohen sepse nuk kemi modele", ka thënë ai.



Nga folësit kjo qendër u cilësua e rëndësishme së veçantë dhe me një koncept të ri, si një urë bashkëpunimi ndërinstitucional, dhe për t'i ndihmuar vendit tonë që dhe rajonit e më gjerë

Hajrizi ka deklaruar se ky është misioni dhe qëllimi që të bëhet qendra kryesore e modelimit-simulimit në Ballkanin Perëndimor. Me prezantime të tyre, rreth kësaj qendre, janë paraqitur edhe profesorët ndërkombëtarë nga Universiteti Teknik i Vjenës, prof.

dr. Felix Breiteneker, njëherësh përfaqësues i EUROSIM-it, Niki Popa, Andreas Korner dhe profesorët e UBT-së, si Mentor Geci etj.

Po ashtu një fjalë përshëndetëse e mbajti edhe drejtori i Departamentin e Shkencës ne

Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Murtez Osdautaj.

"UBT SIM" u themelua si rezultat i një bashkëpunimi të përbashkët me Universitetin e Vjenës e Teknologjisë - Divizionit Matematikë- Modelimi dhe Simulim.

UBT DHE KOSOVA NË IPMA WORLD CONGRESS 2014

Rektori i UBT-së prof. Edmond Hajrizi mori pjesë si përfaqësues i Kosovës në asamblenë vjetore të Organizatës Botërore për Menaxhimin e Projekteve si dhe në Kongresin Botëror të 28-të të Organizatës për Menaxhimin e Projekteve IPMA 2014 Inovacioni ndërmjet Dialogut, që u organizua në World Trade-Center në Rotterdam të Holandës.

Gjatë kësaj vizite, rektori i UBT-së pati takime të shumta me ekspertë, kompani, universitete, institucione akademike dhe qeveritare, gjatë të cilave



u bisedua për mundësinë e bashkëpunimit në fusha të ndryshme

PËRMES UBT-SË

KOSOVA PËR HERË TË PARË NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË ASOCIACIONIT TË SHKOLLAVE EVROPIANE PËR PLANIFIKIM

14 korrik 2014 - Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi për katër ditë më radhë ka qëndruar në Universitetin e Utrehtit të Republikës së Holandës, ku mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Asociacionit të Shkollave Evropiane për Planifikim (AESOP), dhe përfaqësoi UBT dhe Republikën Kosovës në këtë takim.

UBT që nga muaji mars i këtij viti ka fituar pozitën e anëtarit të plotë në këtë Asamble, dhe është shkolla e parë dhe e vetme nga Kosova e pranuar në këtë Asociacionit. Gjithashtu, prof. Hajrizi është zgjedhur përfaqësuesi i parë nacional për Kosovën në këtë Asociacion.



Presidenti Hajrizi pati takime të shumta si me presidentin e organizatës, prof. Gert de Roo, sekretariatit, si dhe me përfaqësues të shkollave të ndryshme nga e tërë Evropa. Ata diskutuan për mundësinë e bashkëpunimit, si organizimin e shkollave verore,

mobilitet të stafit dhe studentëve, si dhe organizimin e eventeve të përbashkëta akademike. Presidenti De Roo shprehu gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar ngushtë me UBT në të ardhmen. UBT është zgjedhur në procesin e vlerësimit të shkollave për planifikim duke u bazuar në parimet evropiane.

Presidenti Hajrizi mori pjesë edhe në Kongresin vjetor të kësaj organizate FromControl to CoEvaluation, i cili është organizuar paralel me takimin ku morri pjesë me debate në sesione të ndryshme. Po ashtu një rast i mirë ishte për të vizituar edhe Universitetin dhe parkun shkencor të Utrehtit.

UBT BASHKËPUNON ME AMBASADËN E SHBA-SË NË KOSOVË

17 qershor 2014- Me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, një delegacion nga Ambasada e SHBA-ve në Kosovë, si Remzije Potoku dhe Kanishka Gangopadhyay vizituan UBT-në.

Delegacioni në fjalë u prit nga presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe bashkëpunëtorët e tij.

Delegacioni gjatë këtij takimi konfirmoi mbështetjen e institucionit që përfaqëson për promovimin e ndërmarrësisë si pjesë

esenciale e zhvillimit ekonomik dhe ofrimit të perspektivës për studentët e UBT-së. Ata theksuan se granti i SHBA-së do të mbështesë UBT-në në krijimin e resurseve bashkëkohore për mësimdhënie në ndërmarrësi, krijimin e inkubatorit biznesor virtual, hulumtimin rreth ndërmarrësisë dhe shkëmbimin e përvojave me universitetet amerikane.

Ata po ashtu paraqitën përkushtimin e kësaj ambasade për të ndihmuar studentët e UBT-së për studime post-diplomike, vi-

zita profesionale dhe rreth mënyrave të bashkëpunimit në përfundimin e kulturës së ndërmarrësisë në Kosovë përmes avokimit për lehtësi në hapjen e bizneseve nga studentët.

Si pjesë e partneritetit afatgjatë, Ambasada e SHBA-së dhe UBT u përkushtuan të punojnë në gjetjen e mënyrave për avancimin e zhvillimit profesional, përmirësimin të ambientit biznesor dhe mbështetjen institucionale për vetëpunësim dhe ide kreative biznesore të studentëve.



Si pjesë e partneritetit afatgjatë, Ambasada e SHBA-së dhe UBT u përkushtuan të punojnë në gjetjen e mënyrave për avancimin e zhvillimit profesional, përmirësimin të ambientit biznesor dhe mbështetjen institucionale për vetëpunësim dhe ide kreative biznesore të studentëve

Gjithashtu, delegacioni vizitoi UBT-në dhe u nda i kënaqur më

të arriturat dhe punën që bëhet në këtë institucion.

ME RASTIN E SHËNIMIT TË TREVJETORIT TË AGJENCISË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

UBT NËNSHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME ASHMDHP

30 qershor 2014 - Në një ceremoni solemne të organizuar me rastin e shënimit të trevjetorit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP), presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe Mbikëqyrësin kryesor shtetëror

z. Ruzhdi Jashari, në prani të të ftuarve e nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional.

Duke folur para të pranishmëve, prof. dr. Edmond Hajrizi tha: "Përveç që kam kënaqësi të jem pjesëmarrës në ceremoninë e shënimit

të trevjetorit, ne si institucion arsimor kemi përgjegjësi të tona të larta që nënkupton afrimin e kadrove, hulumtime dhe zhvillime në këtë fushë. Ne si institucion, që e kemi numrin më të madh të studentëve në fushën e teknologjisë në Ballkan, e kemi futur në

strategjinë tonë të hulumtimit dhe zhvillimit, po ashtu kemi krijuar një program të veçantë të studimit që ka të bëjë me të dhënat dhe privatësinë".

Gjatë ceremonisë iu dorëzuan mirënjohje zyrtarëve të mbrojtjes së dhënave personale, të cilët pu-

nuan me sukses nëpër institute të ndryshme në Kosovë.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucion i pavarur ka përgjegjësinë ligjore për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale.

NË FUSHATËN INFORMUESE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË KOSOVË

UBT MBËSHTET AGJENCINË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në kuadër të fushatës informuese për mbrojtjen e të dhënave personale në Kosovë, ASHMDHP së bashku me partnerët mbështetës të këtij projekti, do të organizojë aktivitete të ndryshme promovuese, tryeza të rrumbullakëta me shoqërinë civile, mediat, trajnime për të rinjtë e 20 komunave nga e gjithë Kosova si dhe me zyrtarë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Me anë të kësaj iniciative synohet të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve për mbrojtjen e të dhënave personale, e drejtë që iu garantohet dhe me Kushtetutë.

UBT ka nënshkruar dhe një marrëveshje bashkëpunimi me ASHMDHP në qershor të këtij viti duke i mundësuar kësaj agjencie ofrimin e kadrove të specializuara, projekte hulumtuese dhe

zhvilluese në fushën e mbrojtjes të të dhënave personale.

UBT do të mbështes këtë fushatë me anë të ekspertëve, punimeve shkencore si dhe do të mundësojë bursa për studentë.

Në Kosovë, UBT është i vetmi institucion i arsimit të lartë i akredituar në Fushën e Sistemeve të Informacionit në Sigurinë e Informacionit dhe Privatësinë.



UBT MERR PJESË NË UORKSHOPIN E KOMISIONIT EVROPIAN PËR SHKENCË DHE INOVACION "ASISTENCË TEKNIKE HORIZON 2020"



Qëllimi i këtij uorkshopi është të ofrojë informacione dhe asistencë teknike për hartimin dhe aplikimin për projekte në kuadër të programit Horizon 2020.

Presidenti i UBT-së prof. dr. Edmond Hajrizi është edhe pikë kontakti kombëtare për fushën e teknologjisë së informacionit dhe atyre të reja dhe emergjente.

Gjatë kësaj konference janë diskutuar strategjitë e programit për Kosovën. Ky program ka për qëllim të ndihmojë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të ofrojë mundësi për projekte inovative, të cilat ndihmojnë dhe mundësojnë krijimin e vendeve të reja të punës.

Pjesëmarrës në këtë uorkshop ishin përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, institucioneve kërkimore, shoqëria civile etj.

UBT ka investuar dhe në burimet e saj njerëzore duke ngritur kapacitetet e stafit, për të zhvilluar më tepër projekte të tilla që investojnë në zhvillimin e vendit.

REKTORI I UBT-SË NOMINOHET SI PIKË E KONTAKTIT PËR "HORIZONI 2020"

19 qershor 2014 - Me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, u nominua si Pikë Kombëtare e Kontaktit (PKK) për Programin Kornizë të BE-së për Kërkime dhe Inovacion "Horizoni 2020" në Kosovë, për sektorin - Teknologjitë e reja dhe të së ardhmes/ Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit (TIK). Ky vendim është nënshkruar nga ministri Ramë Buja.



UBT ZGJERON BASHKËPUNIMIN

UBT NËNSHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME USHT

1 korrik 2014 - UBT në kurorëzimin e bashkëpunimeve me universitetet e tjera nga vendi, rajoni dhe bota, ka nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi edhe me Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Prorektori për arsim i USHT-së, prof. dr. Fehari Ramadani dhe drejtori për çështje akademike i UBT-së, prof. dr. Ibrahim Krasniqi, në marrëveshjen për bashkëpunim që e firmosën janë dakorduar që mes dy institucioneve të larta arsimore të ketë bashkëpunim në projekte multilaterale. Marrëveshja parasheh që nga të dy palët të jepjen këshilla për ngritjen dhe funksionalizimin e laboratorëve për lëmi përkatëse, të realizohet përdorimi i materialeve sekondare në industri dhe të përdoret energjia efiçente në ndërtim dhe karakteristikat fizike të materialeve.

Në këtë bashkëpunim mes Universitetit Shtetëror të Tetovës dhe UBT-së rëndësi e veçantë i është kushtuar organizimit të aktiviteteve shkencore dhe akademike. Në këtë drejtim do të ketë shkëmbim të stafit akademik, për seminare dhe ligjëratë, në Tetovë dhe Prishtinë, të bëhet shkëmbimi i stafit akademik për studentë të masterit dhe studentë të doktoratës për të kryer eksperimente të përbashkëta shkencore. Për këtë, lehtësirat dhe hapësirat ekzistuese reciproke mund të përdoren pa pagesë. Gjithashtu, marrëveshja parasheh të bëhen publikimet e përbashkëta në revista të referuara për të rritur shanset e sponsorëve të projektit, si dhe faqja e internetit për bashkëpunimin të jetë në gjuhën gjermane, angleze dhe shqipe.

Njëherit, në këtë marrëveshje palët janë marrë vesh që t'i shfrytëzojnë financimet e jashtme për projekte të përbashkëta, të realizohet integrimi i partnerëve të industrisë lokale, kur është e nevojshme përfshirja e temave të diskutuara, si dhe së bashku të marrin pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.



STUDENTËT E UBT-SË MORËN PJESË NË PANAIRIN E PUNËS 2014

Alban Gërguri, nga kompania "Trokit" u shpreh se punonjësit më të mirë në kompaninë e tij janë studentët e UBT-së

27 maj 2014 – Në kuadër të bashkëpunimit të Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK), dhe me qëllim të zbutjes së papunësisë në Republikën e Kosovës, kjo shoqatë organizoi panairin e punës ku ishin prezentë edhe studentët e UBT-së, të organizuar nga Qendra e Karrierës brenda këtij institucioni.

Panairi i organizua nga STIKK kishte synimin që të prezantojë para studentëve dhe të interesuarve të tjerë mundësitë e punësimit në disa prej kompanive të sektorit të TI-së dhe tjera në Republikën e Kosovës.

Në kuadër të këtij panairi të punës u prezantuan kompani prestigjioze dhe që shquhen për profesionalizëm dhe në vend dhe më gjerë.

Pasi vetëm UBT njihet në vend dhe më gjerë për cilësinë dhe zhvillimin e Fakultetit të për Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, dhe Fakultetin Menaxhment, Biznesit dhe Ekonomi, dhe në të nuk mungoi as pjesëmarrja e studentëve të këtyre drejtimeve studimore.



Interesim i madh për drejtimet e UBT-së

Organizatorët dhe bizneset prezentë përgëzuan angazhimin e studenteve të UBT-së dhe institucionin në përgjithësi.

Ndërsa nga ana tjetër z. Alban Gërguri, nga kompania "Trokit" u shpreh se punonjësit më të mirë në kompaninë e tij janë studentët e UBT-së.

UBT-JA U PREZANTUA NË PANAIRIN E EDUKIMIT



29 maj 2014 - UBT është prezantuar me të gjitha programet e studimit, trajnime, kurse, certifikime dhe bursa, në Panairin e Edukimit, në të cilin paralelisht po zhvillohet edhe Panairi i Turizmit, Udhëtimeve dhe Hotelarisë në hollin e Pallatit të Rinisë, në Prishtinë.

"Investimi në një arsim të mirë ia vlen dhe është i domosdoshëm për zhvillimin politik dhe zhvillimin ekonomik të një vendi, sidomos për Kosovën", tha përfaqësuesja e Ambasadës Gjermane, Milena Tutsch.

Ndërkaq, zyrtarët e UBT-së janë shprehur të kënaqur për interesimin e nxënësve, maturantëve, prindërve, studentëve dhe tjerëve për programet e studimit, që i ofron

UBT-ja dhe përveç bursave tjerë edhe për bursat nëpërmjet projektit "Erasmus Mundus", të cilat i jep veç UBT-ja dhe projektit "AEP", etj.

Ata kanë thënë se pjesëmarrësit janë interesuar të dinë për robotët NAO, teknologjinë e fundit të robotëve humanoidë, të vetmit robotë në Republikën e Kosovës dhe në tërë Ballkanin, për rëndësinë e tyre në vendin tonë, ndërlidhja e tyre me studimet dhe si ka arritur UBT-ja që t'i sjellë në Prishtinë.

Shumë nxënës të shkollimit fillor, të emocionuar, pasi janë përshëndetur me robotët NAO i kanë parë demonstrimet dhe vallëzimet e ndryshme të tyre.

FOTOREPORTAZH

Roboti NAO performoi live në Panairin e Biznesit në Pallatin e Rinisë. Oferta e UBT-së, atraksion për vizitorët.



EKSPOZOHEN MBI 130 PUNIME TË STUDENTËVE TË FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS TË UBT-SË DHE TË UNIVERSITETIT PECS TË HUNGARISË

“EKSPOZITA TRADICIONALE UBT 2014” MERR PËRMASA NDËRKOMBËTARE

3 qershor 2013 - Në ambientet e Kampusit të ri të UBT-së u hap Ekspozita tradicionale UBT 2014, në të cilën u ekspozuan mbi 130 punime të studentëve të Fakultetit të Arkitekturës të UBT-së dhe studentëve të Universitetit Pecs të Republikës së Hungarisë.

Të pranishëm në ceremoninë e hapjes së ekspozitës ishin studentë dhe profesorë vendorë e ndërkombëtarë, prindër, përfaqësues të institucioneve të vendit, përfaqësues të universiteteve dhe institucioneve të tjera partnere të UBT-së, etj.

Ekspozita u shpall e hapur nga presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, dekani i Fakultetit të Arkitekturës në UBT, dr. BinakBeqaj, drejtori i programit të doktoratës në Universitetin Pecs, ZoltánBachmann, dhe zëvendësdekanja e Universitetit Pecs, dr. GabriellaMedvegy.

“Ky është një grumbullim i punës dhe përvojave të palodhshme të studentëve dhe të profesorëve të të dyja institucioneve, që nënkupton shkëmbimin e përvo-



“Ekspozita në UBT është bërë tradicionale në çdo vit në muajin qershor të kemi të paraqitura punimet e studentëve tanë. Po ashtu edhe studentët këtij fakulteti ndihen të privilegjuar meqë u ka dhënë mundësia të prezantojnë punën e vet para një audience profesional dhe të gjerë”, tha ndërkaq dekani dr. Binak Beqaj

jave dhe njohurive për një temë të caktuar, dhe kjo që po shihet është puna njëvjeçare që është bërë nga studentët në bashkëpunim me profesorët e tyre”, tha

Presidenti i UBT-së, dr. Edmond Hajrizi.

“Ekspozita në UBT është bërë tradicionale në çdo vit në muajin qershor të kemi të paraqitura

punimet e studentëve tanë. Po ashtu edhe studentët këtij fakulteti ndihen të privilegjuar meqë u ka dhënë mundësia të prezantojnë punën e vet para një audience

UBT ndau çmim për Zoltán Bachmann

Arkitektin me përmasa ndërkombëtare Zoltán Bachmann, për kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë në lëmin e arkitekturës prof. dr. Edmond Hajrizi dhe Këshilli Akademik i UBT-së, si shenjë respekti e nderuan me Çmimin më të lartë që parasheh Statuti i UBT, “Leadership Excellence Award”.

profesional dhe të gjerë”, tha ndërkaq dekani dr. BinakBeqaj.

Po ashtu, gjatë kësaj ekspozite u dhanë edhe mirënjohje disa studentëve të të dyja institucioneve për punën e tyre të suksesshme, gjithashtu u dhanë mirënjohje edhe stafit akademik të cilët kanë kontribuar në organizimin e deri te hapja e kësaj ekspozite.

PROFESORI LULZIM BEQIRI MORI TITULLIN DOKTOR SHKENCE NË UNIVERSITETIN E VJENËS

Profesori Lulzim Beqiri mbrojti para disa ditësh me sukses temën e disertacionit dhe mori titullin doktor shkence në Universitetin e Vjenës.

Tema e doktoratës së z.Beqiri ishte “Application of the systems engineering in construction from idea to the final building structure and relation through the process”. Kjo temë, me mjaft interes, ka të bëjë me inxhinierinë e sistemeve, dizajnin e sistemeve në fushën e arkitekturës dhe ndërtimitarisë dhe përfitimet që sjell aplikimi i këtij sistemi.



PRODEKANIT MUHAMET AHMETI I DORËZOHET DIPLOMA E DOKTORATËS



Në një ceremoni solemne të organizuar në Universitetin Teknik të Vjenës TU WEN më 17 tetor 2014, për dorëzimin e diplomave të të gjithëve doktorantëve, ka marrë pjesë dhe i është dorëzuar diploma në prani të 200 pjesëmarrësve dhe prodekanit të Fakultetit të Ndërtimitarisë, z.Muhamet Ahmeti.

Prodekani Ahmeti ka mbrojtur temën e doktoratës në korrik të këtij viti “Impakti i transportit në zhvillimin ekonomik të shteteve të Ballkanit në tranzicion”.

PROFESORRESHA E UBT-SË, KOZETA SEVRANI MORI ÇMIMIN “AKADEMIKU I VITIT”



27 prill 2014- Profesoresha nga Tirana, njëherit edhe ligjëruese me vite të tëra në UBT, prof. dr. KozetaSevrani u nderua me Çmimin “Akademiku i Vitit”, nga “ICTS Media” në Shqipëri, në kuadër të edicionit të dytë të “Albanian ICT Awards”.

Dhënia e çmimit u bë në prani të shumë personaliteteve qeveritare të të dyja vendeve, si nga Shqipëria ashtu dhe nga Kosova, profesorë, ekspertë dhe student të shumë universiteteve.

Profesoresha Sevrani ka botuar një numër të madh tekstesh shkencore universitare, dhe sot studiuësit e njohur, si të huaj ashtu edhe ata vendorë të cilët ligjërojnë në UBT, dhe më tej, në shumicën e rasteve përdorin pandalshëm librat e saj. Prof. Sevrani, sot përveç si ushtrimit të profesionit të pedagoges, ka edhe disa poste nëpër institucione universitare.



Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informativ
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathësi negocimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

Shkathësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktit
- Aqvi Comunnitëre e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatieke
- State Protocol

Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

Teknologji Informativ

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vistër të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.

Kredi për studentë



**Raiffeisen
BANK**

...JETO MË MIRË

Financoni studimet tuaja

- Norma të volitshme interesi
 - 10,000 Euro deri në 5 vjet
 - 0% - shpenzime administrative

www.raiffeisen-kosovo.com
Raiffeisen Direct: 038 222 222

UBT NËNSHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME GIZ-in DHE ME SHOQATËN E GJEODETËVE TË KOSOVËS

12 shtator 2014- Me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, në ambientet e UBT u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit midis UBT-së, Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) dhe me Shoqatën e Gjeodetëve të Kosovës.

Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, në mes të këtyre tria institucioneve, presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hjarizi, së bashku me delegacionin e GIZ-it të prirë nga Gunther Fehlinger dhe Shkumbin Asllani, dhe Murat Hoxha, kryetar i Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës, u tha se,

Me këtë momerandum ne shprehim gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar implementimin e standardeve evropiane në fushën e gjeodezisë, ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale të gjeodetëve dhe

duke synuar ndërlidhjen e mësimin akademik me punë praktike të gjeodetëve dhe anasjelltas.

Ndërkaq, presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hjarizi tha se bashkëpunimi do të realizohet nëpërmjet organizimit të përbashkët të aktiviteteve në fusha të ndryshme nëpërmjet simpoziumeve, konferencave, deba-teve rreth standardeve dhe praktikave më të mira evropiane në fushën e gjeodezisë, projekte të përbashkëta, nëpërmjet të cilave mësimdhënësit, studentët dhe stafit menaxhues të kenë mundësi të përfshihen në projekte të përbashkëta që do të ndërmerren nga GIZ dhe Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës.

Po ashtu, ofrimi i shërbimeve profesionale, edukimit dhe trajnimit për gjeodetët anëtarë të Shoqatës duke i shfrytëzuar resurset humane dhe teknologjitet që i posedon UBT.



Me këtë momerandum ne shprehim gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar implementimin e standardeve evropiane në fushën e gjeodezisë, ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale të gjeodetëve dhe duke synuar ndërlidhjen e mësimin akademik me punë praktike të gjeodetëve dhe anasjelltas

Të pranishmit biseduan edhe për objektivat zhvillimore dhe aktivitetet vepruese që tria institucionet do t'i kenë në periudhën vijuese konform marrëveshjes së nënshkruar.

REKTORI HAJRIZI: "STANDARDET - MUNDËSI PËR TË TËRË"

Në kuadër të ditës Ndërkombëtare të Standardeve, Agjencia Kosovare e Standardizimit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë ka mbajtur aktivitetin e përvitshëm "Dita Botërore e Standardeve".

Pjesëmarrës për të disatën herë ishte dhe rektori i UBT prof.dr. Edmond Hajrizi, i cili mbajti një fjalim "Standardet Mundësi për të tërë". Ai ka theksuar në këtë aktivitet

se "Ndërmjet standardeve ne mund të fitojmë sukses, kurse përfitues të standardeve janë konsumatorët".

UBT është i vetmi institucion i Arsimit të Lartë në Kosovë i pajisur me standardin për cilësi ISO 9001:2008. UBT ka themeluar organizatën Quality Kosova e cila është anëtare e plotë e Organizatës Evropiane për Cilësi (EOQ).



PËRMES PROJEKTIT TEMPUS

DREJTUES TË UBT-SË NË VIZITË NË GJERMANI

10 shtator 2014 – Drejtues dhe përfaqësues të UBT-së nëpërmjet projektit TEMPUS- Energji Efiçente, kanë realizuar një vizitë studimore në Republikën e Gjermanisë, ku kanë vizituar Universitetin Bauhaus, shkolla, institute, kompani dhe ministri, në Dessau dhe Berlin.

Stafi i UBT-së, kishte mundësi të vizitonte institucione të ndryshme shtetërore dhe private, universitete dhe objektin e "Bauhasit".

Qëllimi i vizitës ishte njohja më për së afërmi me shkollimin profesional, me theks të veçantë në fushën e energjisë efiçente në ndërtesa, por edhe atë alternative, si dhe pajisjet didaktike për këtë fushë, si pjesë e projektit TEM-



PUS, të financuar nga Komisioni Evropian, ku UBT është përfituese. Gjithashtu, gjatë vizitave u diskutua edhe për bashkëpunim në të ardhmen.

UBT-ja nëpërmjet këtij projekti ka zhvilluar qendrën e vete për Ener-

gji dhe Programin e Studimit, i cili pritet së shpejti të vlerësohet nga ekspertët ndërkombëtar.

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, vizitoi edhe partnerët tjerë gjerman në Wiesbaden dhe Frankfurt të Gjermanisë.

UBT ANËTARËSON KOSOVËN NË IASP



UBT - Science and Innovation Campus

Affiliate Member

Postal address: Lagja Kalabria p.n., Prishtine, 10000, Kosovo

General e-mail: info@ubt-uni.net

Phone: +381 38 541 400

Fax: +381 38 542 138

Web: www.ubt-uni.net

Main Contact: Prof. Edmond Hajrizi, President, ehajrizi@ubt-uni.net

Main sectors: ICT & Communications
Robotics and Plant Automation
Mechanics, Subassemblies, Components

Total surface (area): 3.5 Hectares



Kampusi i Inovacionit UBT është tashmë anëtar i IASP-rjetit mbarëbotëror të parqeve shkencore dhe të fushave të inovacionit. Misioni kryesor i anëtarëve të IASP është të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik kombëtar dhe botërorë ndërmjet inovacionit, ndërmarrësisë dhe transferimit të dijes dhe teknologjisë

Si i tillë kampusi i inovacionit të UBT-së ka për qëllim ngritjen e një rrjeti profesionalistësh që menaxhojnë fushat e inovacionit dhe parqet e shkencës e teknologjisë si dhe krijimin e mundësive të reja për kompanitë dhe zhvillimin e biznesit.

UBT PËR HERË TË TRETË PËRFITUES I PROJEKTIT "ERASMUS MUNDUS"- "SIGMA AGILE"

Nga ky projekt shumë studentë të UBT, sikurse në vitet e kaluara, do të fitojnë bursa të plota studimi për vitin e ri akademik, dhe vitet në vijim, 2014-2018, në të gjitha nivelet e studimit si bachelor, master, doktoratë dhe të postdoktoratë

4 korrik 2014- UBT në vazhdimësi është përfituese e projekteve ndërkombëtare të sektorit të arsimit në Evropë dhe më gjerë. Përveç të tjerave, këtë vit për herë të tretë është përfituese e projektit "ERASMUS MUNDUS", projekt i Bashkimit Evropian. Nga ky projekt shumë studentë të UBT, sikurse në vitet e kaluara, do të fitojnë bursa të plota studimi për vitin e ri akademik, dhe vitet në vijim, 2014-2018, në të gjitha nivelet e studimit si bachelor, master, doktoratë dhe të postdoktoratë, të cilët do të fillojnë mobilitetin e tyre në universitetet më prestigjioze të vendeve të Bashkimit Evropian.

Përveç bursave të studimit projekti "ErasmusMundus" - "SIGMA Agile" përfshin edhe aktivitete tjera si trajnime në ndërmarrësi, menaxhment, shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë etj.

Përmes këtij projekti, i cili ka një buxhet prej 3.000.000 € dhe do të zgjasë nga viti 2014 deri në vitin 2018, do të ofrohen 156 bursa.

Në kuadër të projektit "ERASMUS MUNDUS", përfshihen 20 universitete nga rajoni dhe Evropa, prej tyre 11 vendet e Ballkanit, dhe 9 nga Evropa. Ndryshe UBT është i vetmi institucion privat nga Republika e Kosovës që është



Përmes këtij projekti, i cili ka një buxhet prej 3.000.000 € dhe do të zgjasë nga viti 2014 deri në vitin 2018, do të ofrohen 156 bursa

përfituese e këtij projekti në fjalë, i cili projekt është në vazhdimësi edhe për katër vitet e ardhshme për studentët e UBT-së.

Partnerët e projektit ku mund të studiojnë studentët tanë janë: University of Warsaw-Poland City University London-UK, Hum-

boldt Universitāt zu Berlin-Germany, Lappeenranta University of Technology-Finland, University of Milan-Italy, University of Salzburg-

Austria, University of Twente, ITC Faculty-Netherland, UNIVERSITAT POMPEU FABRA-Spain, University Nova de Lisboa-Portugal.

UBT RICERTIFIKOHET PËR CILËSI SIPAS STANDARDIT NDËRKOMBËTAR ISO 9001: 2008

10 qershor 2014- Pas një auditimi të suksesshëm, UBT është ricertifikuar për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë sipas standardit të njohur ndërkombëtar ISO 9001:2008, edhe për tri vitet e ardhshme.

Kjo certifikatë është lëshuar pas auditimit dhe raportit pozitiv, nga zyrtarët e Institucionit "QUALITY AUSTRIA dhe The International Certification Network (IQNet).

Ky certifikim tregon se UBT i ka përmbushur të gjitha kriteret e këtij standardi në tërë sistemin e vet.

Vlen të theksojmë se UBT është i vetmi Institucion i Arsimit të Lartë në Ballkan, që ka arritur të marrë këtë certifikatë nga viti 2007.

Vetëm 5 për qind të universiteteve në botë thuhet se posedojnë Certifikatë nga ISO 90.



UBT PËR HERË TË KATËR PËRFITUES I PROJEKTIT "ERASMUS MUNDUS"- "GREEN TECH WB - GREENTECH"



3 korrik 2014- UBT për herë të katër është përfituese e projektit të Bashkimit Evropian- "ERASMUS MUNDUS GREEN", me theks të veçantë projektit "TECH WB -GreenTech: SmartandGreen Technologies forInnovativeand-SustainableSocieties in Western-Balkans".

Nga ky projekt shumë studentë të UBT-së, sikurse në vitet e kaluara, do të fitojnë bursa të plota studimi për vitin e ri akademik, dhe vitet në vijim - 2014-2018, në të gjitha nivelet e studimit, si bachelor, master, doktoratë dhe të postdoktoratë.

Në kuadër të këtij përfshihen 37 universitete nga rajoni dhe Evro-

pa, prej tyre 22 vendet e Ballkanit, dhe 15 nga Evropa, ndryshe UBT është i vetmi institucion privat nga Republika e Kosovës dhe rajoni, që është përfituese e projektit.

Partnerët e projektit ku mund të studiojnë studentët tanë janë: EuropeanUniversitiesUniversidade de Vigo, Universidade do Porto, Universitāt Paderborn, University of Ljubljana, University of Economics In Katowice, University of Split, University of Chemical Technology and Metallurgy, Universidad de León, Juraj Dobrila University of Pula, University of Zagreb, University of Bordeaux, Università Telematica Internazionale UNINETTUNO,

Lodz University of Technology, Uniwersytet Gdański, Vilnius Gediminas Technical University.

Përveç universiteteve, në projekt janë përfshirë edhe 10 institucione të ndryshme si ministri, laboratorë, institute hulumtuese, si: Ministry of Education, Science and Technology of the Republic of Kosovo, Centre for Information and Recognition of Qualifications in Higher Education, Bosnia and Herzegovina, Agency for development of higher education and quality assurance BIH, Erasmus Student Network Aisbl, Santander Group European Universities Network, Gdansk Science&Technology Park.

UBT ME QENDRËN E PARË TË KARRIERËS NË KOSOVË

Orientimi profesional në UBT fillon nga dita e parë e studentit, duke i përcjellë gjatë gjithë kohës. Këtu studentët orientohen për programet e studimit, programet ndërkombëtare, karrierën e tyre profesionale, si dhe shumë elemente tjera të cilat janë me interes, respektivisht në kohën e përzgjedhjes së specializimit në vitin e parafundit

Shkruan: Halil Bashota

Qendra e Karrierës në UBT, është themeluar si njësi e veçantë dhe për herë të parë në Kosovë, me qëllim që t'u shërbejë studentëve në fakultetet respektive të ndërlidhin procesin akademik me praktikën dhe zhvillimin profesional. Ndaj që nga themelimi QK ka shërbyer që studentët të



kenë shërbimet e karrierës brenda UBT-së, me qëllim që gjatë kohës së studimeve, atyre tu ofrohen edhe shërbime tjera siç janë: Shërbimet e orientimit profesional, trajnimet, konsulencat e ndryshme si dhe internshipi.

Orientimi profesional në UBT fillon nga dita e parë e studentit, duke i përcjellë gjatë gjithë kohës.

Këtu studentët orientohen për programet e studimit, programet ndërkombëtare, karrierën e tyre profesionale, si dhe shumë elemente tjera të cilat janë me interes, respektivisht në kohën e përzgjedhjes së specializimit në vitin e parafundit. Rëndom kemi studentë të cilët jo gjithmonë janë të orientuar në profesionet që ata

zgjedhin. Mund të jetë një preferencë shoqërore apo e ndonjërit nga prindërit dhe familjarët, por assesi të orientuar profesionalisht mbi ndonjë analizë paraprake të mirëfilltë mbi tregun e punës. Sa i përket pjesës së zhvillimit profesional, studentët mund të përfitojnë një numër të madh të programeve të trajnimeve profesionale, si ato të shkrimit akademik se si të shkruajmë bukur? Si të shkruajmë letër motivuese? CV-të dhe letër rekomandimet. Këtu përfshihen edhe pjesa e trajnimeve të karrierës që përbën një atraksion të veçantë për studentët tanë. Deri më tani ne kemi ofruar trajnime të ndryshme që janë ndërlidh me shkathtësitë e nevojshme për të kërkuar punë dhe madje edhe punësuar në kompanitë më prestigjioze vendore dhe të rajonit.

Ndërsa, praktikës profesionale apo internshipit të studentëve në UBT i kemi dhënë rëndësinë e veçantë, si i vetmi institucion i arsimit të lartë në Kosovë që kemi themeluar Qendrën e Karrierës dhe kemi nisur praktikën profesionale

me një start enorm duke arritur që të sistemojmë 80 % të studentëve në praktikë, si pjesë e bashkëpunimit të mirë me kompanitë më prestigjioze si dhe institucionet publike dhe private në vend. Ne e kemi internshipin obligativ që obligon studentët e programeve respektive, siç është arkitektura, ku në semestrin e fundit studentët kanë lëndën e praktikës profesionale e cila i detyron studentët që patjetër të sistemohen në ndonjë kompani apo institucion, si dhe pjesa e programeve ku praktika vlerësohet brenda programit, por nuk i atribuohet vetëm një lënde akademike.

Ndaj mund të them me siguri të plotë që funksionalizimi i Qendrës së Karrierës në UBT, ka fuqizuar maksimalisht procesin e punës së studentëve, si dhe ka shtuar shanset e tyre për t'iu qasur tregut të punës përmes përvetësimit të shkathtësive profesionale, shkathtësi të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme, respektivisht për gjetjen e vendit të punës.

STUDENTËT DHE LITERATURA PËR STUDIME E HULUMTIME

BIBLIOTEKA E UBT-SË, GJITHNJË NË SHËRBIM TË STUDENTËVE

Biblioteka e UBT-së është një bibliotekë institucionale në shërbim të qëllimeve hulumtuese dhe arsimore në Universitetin për Biznes dhe Teknologji.

Biblioteka posedon një hapësirë të përshtatshme në objektin në Prishtinë, në Kampusin Inovativ në Lipjan, në UBT Ferizaj dhe UBT Prizren.

Biblioteka e UBT-së i shërben të gjithë shfrytëzuesve, në studime bachelor, master, personelit akademik (profesorëve dhe asistentëve) dhe studiuesve nga Kosova.

Ajo mbledh, bën të mundur qasjen dhe i ruan materialet bibliotekare me qëllim të mbështetjes së plan programit të UBT-së dhe plotëson nevojat hulumtuese të shfrytëzues vetë bibliotekës.

Qëllimi kryesor i bibliotekës është të sigurojë literaturë dhe materiale të tjera nga lëmitë:

- Shkenca kompjuterike dhe Inxhinierisë,
- Mekatronikë,
- Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi,
- Arkitekturë,
- Inxhinieri të Ndërtimit dhe Infrastrukturë,
- Juridik,
- Shkenca Politike,
- Sistemet e Informacionit,
- Media dhe Komunikim.

Përveç literaturës që përfshin fushat e studimit në UBT, biblioteka posedon edhe libra nga Mjekësia, Psikologjia, Filozofia, Romane të ndryshme, etj. Fondi i librave përfshin 40.000 libra në bibliotekë.



UBT aktualisht ka bibliotekën më të pasur në kuadër të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe një numër të konsiderueshëm të gazetave, raporteve ndërkombëtare, CD-ve, gazetave lokale, ndërkombëtare dhe gazetave të tjera periodike.

Koleksioni është i radhitur sipas Klasifikimit Universal Decimal, që do të thotë ka një radhitje sipas përmbajtjes së materialit.

Koleksioni i UBT-së përbëhet nga: Koleksioni i përgjithshëm që përfshin të gjithë librat nga fushat e përgjithshme;

Koleksioni referal që përfshin: fjalorë, enciklopedi, almanakë dhe materiale të tjera;

Koleksioni lëndor përfshin librat që janë në përputhje me kërkesat që parashihen nga planprogrami i UBT-së;

Koleksioni i periodik përfshin gjithë gazetat dhe revistat;

Koleksioni i veçantë përfshin dorëshkrimet, magjistraturat, doktoratat.

Studentët mund të sigurojnë libra dhe revista edhe nëpërmjet burimeve elektronike:

- EBSCO;
- Jstor Library;
- Bione;
- IMF e-Library;
- Cambridge Journals.

Këta tituj të librave janë të renditur në raftet e kësaj biblioteke dhe mund të shfrytëzohen nga të gjithë të interesuarit. Biblioteka e UBT-së, është e hapur për student dhe stafin e vet çdo ditë pune prej orës 09:00 deri në ora 17:30.

Liridona Bytyçi

FLASIN STUDENTËT

“KËNAQËSI TË STUDIOSSH NË NJË UNIVERSITET SI UBT”

Kastriot Kasumi dhe Drin Jakurti studentë të vitit të parë në drejtimin Media dhe Komunikim, përmes këtij shkrimi shpalosën mendimet e tyre për UBT-në

Se UBT është në rritje të vazhdueshme si nga ana e kualitetit por edhe nga numri i studentëve kjo është e pamohueshme. Ka shumë arsye që ky pohim ngritet në majën e së vërtetës dhe gjatë rrugës ky fakt përballtet me “kundërshtarët” e vet, të cilët kanë përvojën por dhe peshën e emrit.

Kur themi se dikush ka përvojën dhe peshën e emrit, atëherë çfarë mund të jetë ajo diçka që UBT duhet ta ketë për t'iu përballur dhe për të mbijetuar me konkurrencën e madhe dhe për t'iu sjellëkuadro me kualitet të lartë të dijës shoqërisë sonë.

UBT-ja është e përbërë nga një grup profesorësh që janë të përgatitur, kanë përvojën dhe shkollimin adekuat për të ofruar mundësi të drejtpërdrejta që studentët më pas të përfitojnë nga ta. Studentët nga ana e profesorëve konsiderohen si elitë e së ardhmes që do të ndërtojnë karierrën që e kanë ëndëruar gjithmonë. Ajo që UBT ofron dhe është armë e fortë e saj në krahasim me universitetet e tjera, është bashkëpunimi mes studentëve dhe profesorëve.

Gatishmëria e profesorëve që të jenë në dispozicion të studentëve në çdo kohë, është prioritet i universitetit, dhe është ajo që shumë universitete janë shumë më mbrapa dhe kjo duke nisur nga shumë eksperiencat personale ku rëndësia e studentit dhe e dijës së tij është vënë në harresë. Këtë UBT-ja nuk e lejon dhe kjo është fusha ku UBT-ja është duke e kapur majën e arsimimit të lartë.

UBT, përveç tjetërave, ka përparësi të shumta, si p.sh. transparencja e cila në universitetet e tjera nuk vie në shprehje, pasi që gjërat bëhen dhe askush nuk të jep llogari se çfarë ka ndodhur!

Ka raste kur edhe pranohesh në një universitet, publikohet lista e të pranuarve, por pas pak orësh lista largohet nga ueb-faqja e universitetit dhe shihen ndryshime të shumta në emrat e të pranuarve! Ndër gjërat e tjera të rëndësishme është se UBT ofron kushte të mira për praktikë gjë që universitetet e tjera nuk e ofrojnë.

UBT ofron kushte të mira për studime, ofron mundësitë më të mira për një zhvillim profesional, ofron përgatitje tejet të mirë teorike dhe praktike në secilën nga degët e saj. Është kënaqësi të studiosh në një universitet si UBT.

**Kastriot Kasumi & Drin Jakurti
Media dhe Komunikim, Viti I**

ANKETË ME DISA NGA KRYETARËT E DREJTIMEVE NË UBT

KOMUNIKIMI I SHPESHTË ME STUDENTËT, ÇELËS I SUKSESIT



Studentët udhëheqës të grupeve të fakulteteve në UBT, flasin për "UBT news"

Pyetje: Ju si kryetar/e drejtimi tuaj çka premtori për grupin?

Arrita Deva: Si kryetare e zgjedhur nga kolegët e mi të grupit për studime të Shkencave Politike premtor shumë angazhim, punë dhe rezultate sa më të suksesshme në krijimin e profesionit të secilit prej nesh, duke marrë parasysh njohuritë për lëndën.

Blend Humolli: Nuk premtor asgjë tjetër, përveç prezantimit të denjë të interesave dhe pakënaqësive të secilit student në instanca më të larta të UBT-së, për drejtimin e Ndërtimitarisë.


Vjollca Musliu: Unë si kryetare e grupit të juristëve të ardhshëm të UBT-së premtor të dhëna të shpejta dhe efikase për kolegët e mi dhe të dhëna të shpejta të informacioneve.

Taulant Hyseni: Unë si kryetar i drejtimin të Arkitekturës në UBT premtor angazhim serioz si dhe sukses të lartë.

Pyetje: Sa kanë interesim studentët për ligjëratat?

Arrita Deva: Duke marrë parasysh lëndët që i mësojmë gjatë leksioneve, padysim se ato janë tërheqëse dhe mjaft të rëndësishme për profesionin tonë të ardhshëm. Në këtë aspekt, studentët kanë mjaft interesim të madh duke qenë të pranishëm gjithmonë në leksion edhe duke bërë pyetje interesante për sa i përket lëndës së caktuar.

Blend Humolli: Interesimi i studentëve është mbi mesatare, sepse edhe vetë drejtimi kërkon më shumë përkushtim dhe pjesëmarrja në ligjëratat



domosdo që luan një rol të rëndësishëm në këtë aspekt.

Vjollca Musliu: Sa u përket ligjëratave janë të interesuar pjesërisht, ku me këtë rast ju bëj thirrje publike kolegëve të mi të jenë më të interesuar në ndjekjen e ligjëratave akademike.

Taulant Hyseni: Interesimi për ligjëratat është i mirë, studentët i dëgjojnë me vëmendje ligjëratat.

Pyetje: Sa shpesh mbani mbledhje brenda në grup?

Arrita Deva: Qysh në fillim, ne si grup i shkencave politike kemi qenë mjaft komunikues dhe shoqëror sa i përket marrëdhënive tona studentore. Varësisht prej interesimit, i cili çdo semestër po shtohet për studentët e UBT-së e veçanërisht të shkencave politike, ne mbajmë mbledhje tre herë në javë. Nëse ka ndonjë çështje specifike, e cila duhet të diskutohet me grupin për ndonjë lëndë, e mbajmë edhe gjatë leksioneve bashkë me profesorin përkatës dhe gjejmë zgjidhjen e duhur gjithmonë, e cila na bën neve që të jemi sa më të vëmendshëm në hapat tonë të ardhshëm si politologë.

Blend Humolli: Mbledhjet mbahen jo me ndonjë itinerar të caktuar, mirëpo kur shfaqet interesimi i studentëve gjithçka është e mundur dhe realizohet shpejt.

Vjollca Musliu: Bashkëpunimi jonë në grup është mjaft i shpeshtë, ku sa më shumë njihemi me njëri-tjetrin e kuptojmë se kemi ambicie të njëjtë për studimin e drejtësisë, dhe në këtë mënyrë çdo ditë e më shumë bëhemi më funksional si grup.

Taulant Hyseni: Çdo javë mbajmë mbledhje.

Anketën e realizoi: Ilaz Luzha, Media dhe Komunikim/Viti i dytë



STUDENTËT E UBT-SË NË UNIVERSITETE BOTËRORE

FLET HERMONDA KALLUDRA, STUDENTE NË UNIVERSITETIN E VARSHAVËS

UBT News: Mund të na thuash dallimin e kushteve që ofron Universiteti i Varshavës me Universitetin e UBT-së?

Hermonda: Dallimi nuk është edhe aq i madh. Staf kualifikues dhe serioz kanë dy universitetet. Dallimi që mundem me cek janë studentët. Angazhimi i tyre ka qenë jashtë mase i madh.



UBT News: Pse keni zgjedhur pikërisht UBT-në për të studiuar në Kosovë?

Hermonda: Sepse është një ndër universitetet më të mira në Kosovë dhe i jep studentëve shumë mundësi për studime jashtë, si dhe ka staf të kualifikuar.

UBT News: Në çfarë drejtimi jeni duke studiuar në Universitetin e Varshavës?

Hermonda: Drejtimi im është Marrëdhënie Ndërkombëtare.

UBT News: Sa jeni e mirëpritur atje si një shtetase kosovare?

Hermonda: Mikpritja ka qenë tejmas e mirë për mua si një shtetase kosovare, gjë që më ka

bërë të ndihem edhe më mirë dhe menjëherë na bën të ditur se ne jemi studentë të Varshavës dhe nuk kemi pse të ndihemi ndryshe.

UBT News: Cila është ëndrra juaj për të ardhmen?

Hermonda: Të bëj një ndryshim pozitiv në vendin tim.

UBT News: A keni vendosur se ku do jetoni pasi t'i përfundoni studimet?

Hermonda: Karrierën do ta ndërtoj jashtë vendit por kontributin do ta jap në Kosovë dhe jetesën po ashtu.

Albulena Gagica
Media dhe Komunikim, Viti I

NË VETËN E PARË

ÇKA PËRFITOVA NGA VITI I PARË I STUDIMEVE

Synimi i çdo njeriu është që të ketë sukses në jetë, prandaj secili njeri bën përpjekje që të arrijë sukses në studime, në sport, në jetë përgjithësisht. Por, nuk mjafton të kemi dëshira dhe të bëjmë përpjekje. Dëshirat dhe përpjekjet tona duhet të jenë të harmonizuara me qëllimin e mirë.

Natyrish që punën tonë duhet ta vëmë në shërbim të familjes, të shoqërisë e të njerëzimit ashtu që të kemi dobi prej saj. Nëse veprimi është i kështu, sukcesi do të jetë vërtet i garantuar. Kështu nisa vitin e parë të studimeve, e trazuar, plot dilema, por e vendosur t'u futesha punëve me vullnet të hekurt.

Në vështrimin e parë një studente e shkëlqyer mendohet një vlerësim me notën 10. Por për mua të jesh studente e shkëlqyer do të thotë më shumë përpjekje, punë, rezultate, kënaqësia e të qenurit e vlerësuar dhe e krijimit të bazave të forta teorike. E etur gjithmonë e më shumë për thellimin e dijeve, për perfeksionimin e saj dhe për zbatimin e dijeve të përfituara në praktikë. Një studente e shkëlqyer është një pus i thellë në dije, është një gur i çmuar i shoqërisë që meriton jo vetëm mbështetje por edhe mjedis për shpalosjen e aftësive të veta në të mirë të shoqërisë.

Këtë vit më është dhënë mundësia të takoj shumë njerëz të rinj, takova një mori njerëzish.

Ata kaluan para syve të mi, si para një kamere të hapur. Por, disa prej tyre kam përshtypjen sikur i kam njohur prej kohësh, sikur kanë qenë të pranishëm në jetën time qysh kur mbaj mend veten. Ky ka qenë viti më i lumtur i jetës sime, e ndieja veten të lidhur përfundimisht me gjithçka që më rrethonte.

Mbajtja e ligjëratave me kohë dhe me rregull.

Vizita në Tiranë si dhe takimi me presidentin z. Bujar Nishani, më magjepsën.

Nuk është vështirë të dish fundin e rrugës nëpër të cilën ke filluar të ecësh.

Në Universitetin për Biznes dhe Teknologji unë mund të arrij të gjitha qëllimet dhe ëndrrat që kam, ky universitet do të më ofroj një të ardhme më të mirë dhe një karrierë të suksesshme.

Unë jam një studente me shumë ëndrra të mëdha dhe një person e cila ka marrë hapa të mëdha për të arritur atë.

Së fundi, jam e bindur, besoj në veten time, jam optimiste dhe do të përballem me jetën vetëm me një buzëqeshje.

Fillo të bësh realitet ëndrrat e tua duke studiuar në Universitetin për Biznes dhe Teknologji.

Tani është momenti!

Zylfie Thaçi
Media dhe Komunikim, Viti II

GAZETARIA DHE PUSHTETI

GAZETARIA HULUMTUESE NË KOSOVË DHE DISA TË DHËNA PËR SKANDALIN E AFERËS WATERGATE

Vehbi Kajtazi, është një gazetar i ri i së përditshmes "Koha Ditore". Tema lidhet me gazetarinë hulumtuese dhe si shembull e kam marrë gazetarin Vehbi Kajtazin. Ky shkrim ka të bëjë edhe me skandalin e aferës Watergate, shkaqet dhe pasojat që solli ky skandal në historinë gazetareske.

Ai merret me tema hulumtuese, siç janë rastet e përfshirjes së zyrtarëve të lartë shtetërorë në korrupsion e deri tek hetimet që u bëhen grupeve të ndryshme të interesit. Gazetari Vehbi Kajtazi thotë se është gjetur nën trysni për të mos botuar shkrimet e tij dhe se është kërcënuar shumë herë.

Vehbi Kajtazi ka zbuluar korrupsionin në misionin e Bashkimit Evropian EULEX, me çfarë i ka komprometuar prokurorët e jashtëm. Kajtazi me argumente të fuqishme dhe me dëshmi (të insajderëve të brendshëm) ka zbuluar një mori aktakuzash që në këtë mision kanë qenë të montuara ose janë formuar në bazë të kritereve politike. Për këtë është folur gjatë dhe nuk janë dhënë argumente të mjaftueshme. Ai thotë se ishte kërcënuar drejtpërdrejt nga anëtarët e EULEX-it, mbi raportet e tij se zyrtarë të lartë të misionit të ishin të dyshuar për korrupsion. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) është shumë i shqetësuar me presionin që zyrtarë të misionit të EULEX-it në Kosovë i kanë bërë gazetarit të "Kohës Ditore", Vehbi Kajtazi.

Vehbi Kajtazi thotë se është kërcënuar edhe nga disa gjykatës të Kosovës. Po ashtu, ka qenë i kërcënuar nga një person dy herë brenda një periudhe njëvjeçare. Ai ka qenë një ish-komandant i UÇK-së dhe është kërcënuar nga ai për shkak të disa shkrimeve, që ka bërë për vepra penale që kishin kryer djemtë e tij. Ndërsa, herën tjetër ka qenë i kërcënuar nga një

gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, për shkak se ka shkruar se ai është nën hetime dhe po priret që të ngrihet aktakuzë kundër tij për përfshirje në vepra penale. Kërcënimet kanë qenë edhe me likuidim fizik, për shkak të shkrimeve të tij.

AGPK ka kërkuar nga Policia e Kosovës dhe organet e tjera të drejtësisë ndërhyrjen e menjëhershme në këtë rast, ku përveç pengimit të punës së gazetarit, fyhet dhe poshtërohet liria e shprehjes në vend, duke e rrezikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe vetë jetën e gazetarit.

Gazetari Kajtazi mori çmimin parë për Gazetari Hulumtuese. Roli i tij është shembull i gazetarisë hulumtuese, sepse zbulimi i tij karëndësi të madhe në menaxhimin e drejtësisë në Kosovë. Vehbi Kajtazi ka qenë gazetar i vitit edhe në vitin 2012 dhe ka fituar disa herë çmimin për gazetari hulumtuese.

Hulumtimet e gazetarit Kajtazi kanë shkaktuar tronditje, kanë nxitur hulumtime e hetime, qoftë brenda institucioneve vendore, të cilat ai i ka përmendur në tekstet e tij, e sidomos në misionin e Bashkimit Evropian, i cili është i thirrur për ta zbatuar ligjin dhe për ta luftuar korrupsionin në vendin tonë, ndërsa njerëzit e tij vet janë përfshirë në punë të këqija.

Në histori ka shumë raste kur zbulimi i skandaleve të mëdha shtetërore ka shkaktuar tronditje të mëdha. Një nga këto raste është afëra e njohur me emrin "Watergate"...



Gazetari Vehbi Kajtazi

Herët në mëngjesin e 17 qershorit 1972, disa vjedhës u arrestuan brenda zyrës së Komitetit Demokratik Kombëtar (DNC), të vendosura në ndërtesën Watergate në Washington DC. Kjonuk ishte grabitje e zakonshme: Hajdutët ishin të lidhur me fushatën e rizgjedhjes së presidentit Riçard Nikson (CRP, të quajtur "CREEP" nga kundërshtarët e Nixon-it), dhe ata ishin kapur duke u përpjekur për të përgjuar telefonat dhe duke vjedhur dokumente sekrete. Ndërsa historianët nuk janë të sigurt nëse Nixon dinte për operacionin e spiunazhit të Watergate-t para se të ndodhte.

Watergate erdhi për të simbolizuar përpjekjet e administratës

Nixon-it për të shkatërruar rendin demokratik nëpërmjet veprave penale; shtypjen e lirisë civile; luftën e brendshme ndaj kundërshtarëve politikë përmes spiunazhit dhe sabotimit, auditimet diskriminuese, tatimet mbi të ardhurat, dhe sanksione të tjera ndëshkuese ekzekutive; ngrijet e "parave për heshtje" për vjedhësit, dhe u përpoq shumë në frikësimin e mediave. Roli i drejtpërdrejtë i Presidentit Nixon në përpjekjet e Shtëpisë së Bardhë për të mbuluar përfshirjen e tij në rastin Watergate u zbulua në një kasetë të 23 qershorit 1972, të një bisede me shefin e stafit të Shtëpisë së Bardhë, Haldeman, në të cilën Nixon diskutoi një

plan ku CIA t'i bëjë presion FBI-së që të pushojë hetimin e rastit Watergate, duke pretenduar se sekretet e sigurisë kombëtare do të kërcënohen nëse Byrojado t'i zgjerojë hetimet e veta. Ishte pas kësaj të ashtuquajturës "Smoking Gun", "armë e duhanit", kasetë e cila ishte bërë publike më 6 gusht 1974. Pasi roli i tij në komplotin Watergate kishte dalë më në fund në dritë, presidenti dha dorëheqjen nga posti më 9 gusht 1974.

Gjashtë javë pasi u emërua presidenti i ri, Gerald Ford, ai fali Nixon-in për të gjitha krimet që ai kishte kryer, ose mund të kishte kryer, sa ishte në detyrë. Disa nga ndihmësit e Niksonit nuk ishin aq me fat: ata ishin të dënuar për vepra shumë të rënda dhe u dërguan në burgun federal.

Edhe pse Nixon nuk ishte ndjekur penalisht, skandali Watergate ka ndryshuar politikën amerikane përgjithmonë, duke çuar shumë amerikanë të vënë në pikëpyetje udhëheqjen e tyre dhe të kenë mendime më shumë kritike për presidencën, duke krijuar një atmosferë të cinizmit dhe mosbesimit. Ndërsa shumë amerikanë ishin tmerruar thellë nga rezultatet e Luftës së Vietnamit, Watergate shtoi pakënaqësinë e mëtejshme në një klimë kombëtare tashmë të përkeqësuar nga vështirësitë dhe humbjet e dekadës së kaluar.

Dafina Berisha,
Media dhe Komunikim, Viti I

NËPËR ZHVILLIMET E FUNDIT NË UBT

UBT - AMBASADORI DIJES NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

UBT me të drejtë konsiderohet si ambasadori i dijes dhe shkencës në Republikën e Kosovës. Ky institucion ka marrë çmime dhe mirënjohje të rëndësishme ndërkombëtare. Gjithashtu, ai ka nënshkruar një varg marrëveshjes për bashkëpunim me një varg institucioneve vendore e ndërkombëtare, si dhe zhvilluar një numër aktiviteteve të shumta që e prezantojnë punën e UBT-së, mësimdhënësve dhe studentëve.

Më poshtë, kronologjikisht, do të sjellim disa prej aktiviteteve të rëndësishme të këtij institucioni:

1. 8 mars 2012 - UBT bashkëpunon me Universitetin e UTAH-it në SHBA;

2. 18 prill 2012 - UBT përfitues i projektit Norvegjez AEP për ICT.

3. 30 maj 2012 - Doli nga shtypi numri më i ri i gazetës "UBT News"

4. 13 korrik 2012 - Studentët e UBT-së fituan bursa nga "Ipko-Foundation".

5. 27 nëntor 2012 - Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, UBT promovoi librin shkencor "Rrjetet kompjuterike" dhe revistën shkencore "International Journal for Business, Technology".

7. 6 shkurt 2013 - UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Varshavës.

8. 23 prill 2013 - UBT përgatit zyrtarët e UN Habitatit dhe komunave të ndryshme për Menaxhimin e Projekteve konform praktikave më të mira ndërkombëtare.

9. 20 maj 2013 - UBT ka anëtarësuar Republikën e Kosovës në EUROSIM.

10. 22 tetor 2013 - UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Institutin e Medias së Kosovës.

11. 29 tetor 2013 - UBT përfiton edhe tri vite projektin me SEECEL.

12. 31 tetor 2013 - Studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT vizituan KPM-në.

13. 26 dhjetor 2013 - "Quality Kosova" bëhet anëtare e rregullt dhe me të drejta të plota e Organizatës Evropiane për Cilësi.

14. 27 dhjetor 2013 - UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Fatih në Turqi.

15. 27 janar 2014 - UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me SHKACAK.

16. 13 shkurt 2014 - STIKK: UBT vlerësohet më i miri në vend.

17. 20 shkurt 2014 - UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Freibergut në Republikën Federale të Gjermanisë.

18. 15 mars 2014 - UBT ka marrë pjesë në Konferencë Ndërkombëtare "Quality in Blended Learning".

19. 10 mars 2014 - Studentët nga Universiteti i Oslos për vizitë zgjedhën UBT.

20. 19 mars 2014 - UBT bëhet anëtar me të drejta të plota në AESOP.

21. 24 qershor 2014 - UBT merr çmimin "International Star for Leadership in Quality" në Paris.

22. 24 shtator 2014 - Për herë të parë në Ballkan UBT vlerësohet me çmimin e Ekselencës nga Organizata EFQM.

23. 30 tetor 2014 - UBT fitues për herë të katërt i programit Erasmus-Mundus.

Përgatiti: Flaka Jashari

INTERVISTË ME BESA JAGXHIUN, LIGJËRUESE NË DREJTIMIN E ARKITEKTURËS

“E ARDHMJA U PËRKET ATYRE QË BESOJNË NË BUKURINË E ËNDRRAVE TË TYRE”

UBT News: A ka qenë e lehtë të studiosh në Universitetin për Biznes dhe Teknologji?

Besa Jagxhiu: Natyrisht që studimet kanë kërkuar shumë mund, angazhim dhe sakrificë. Me ndihmën e mësimitdhënësve kam arritur që t'i kryej studimet me sukses, dhe në fund e gjithë kjo ia ka vlejtur dhe është shpëguar.

UBT News: A mund të rrëfeni diçka nga studimet tuaja në UBT?

Besa Jagxhiu: Sigurisht që ka pasur shumë ngjarje gjatë studimeve, por unë do të veçoja pjesëmarrjen time në “International Passive House Summer School for Students” në Spittal an der Drau, Austri, e cila më është mundësuar nga UBT, i cili trajnim më ka ndihmuar shumë në aftësimin tim profesional.

UBT News: Çka ju ka lënë më së shumti përshtypje gjatë studimeve?

Besa Jagxhiu: Duke marrë parasysh që unë studimet për

arkitekturë i kam përfunduar në UP, ndërsa studimet master në arkitekturë, planifikim hapësinor dhe menaxhim të projekteve në UBT, këtu më së shumti më ka lënë përshtypje disiplina studimore, mënyra bashkëkohore e ligjërimit teorik dhe praktik, si dhe përkushtimi dhe motivimi i mësimitdhënësve.

UBT News: Cila ka qenë tema e diplomimit dhe cili ka qenë mentor i juaj?

Besa Jagxhiu: Tema ime ka qenë “Challenges of Urban Development – Case Study - Prizren”, ndërsa mentor i Dr.Sc. Binak Beqaj.

UBT News: Pas diplomimit, cila është puna juaj?

Besa Jagxhiu: Pas diplomimit kam vazhduar punën time në Ndërmarrjen Publike Banesore edhe për një kohë, pastaj kam marrë pjesë në një numër të projekteve të BE-së, dhe, krahas kësaj, kam filluar angazhimin tim si pjesë e stafit akademik në UBT.

UBT News: Cili është hulumtimi i juaj i fundit shkencor që keni publikuar në revista?

Besa Jagxhiu: “Preservation of the Historic Center of Prizren through Integration into Modern Life”.

UBT News: Nëse do t'ju jepej rasti a do ta ndërronit vendin e punës në UBT, të kaloni në ndonjë institucion tjetër?

Besa Jagxhiu: UBT është një nga institucionet më inovative dhe serioze të sistemit të arsimit të lartë në Kosovë dhe në rajon, me programe dhe metoda bashkëkohore studimi, me standarde ndërkombëtare, duke u zhvilluar dhe avancuar çdo ditë e më shumë, ndaj unë nuk do të largohesha nga ky institucion për të kaluar në ndonjë tjetër, pasi që këtu më është dhënë hapësirë e nevojshme për veprim dhe kontribut në zhvillimin e mëtutjeshëm të institucionit.

Intervistoi: Gentiana Hoxhaj, Media dhe Komunikim, Viti II

KONFERENCA E ORGANIZUAR NGA UNIVERSITETI “LUIGJ GURAKUQI” NË SHKODËR

DR. HAJRIZI PARAQITI DY PUNIME SHKENCORE DHE UDHËHOQI SESIONIN PËR ICT

9 qershor 2014 - Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “Kërkimi dhe edukimi - Sfidat drejt së ardhmes” ICRAE 2014, e organizuar nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” në Shkodër të Shqipërisë.

Dr. Edmond Hajrizi udhëhoqi sesionin shkencor për ICT, si dhe prezantoi dy punime shkencore:

“Zhvillimet e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit, një Studim Krahasues për Shqipërinë dhe Kosovën” si dhe “Zhvillimet e Menaxhimit, Sipërmarrjes dhe Edukimit inovativ në shkollat jo biznesore, raste studimore në UBT”.

Synimi kryesor i kësaj konference ishte promovimi i zhvillimit të procesit të edukimit e të kërkimit shkencor.

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin studiues nga 26 shtete të botës, të cilët kanë referuar në temat kryesore lidhur me: TIK (Teknologji e Informimit dhe e Komunikimit), Media dhe Komunikim, Filologji, Sporte, Shkenca Shoqërore, Kërkim Shkencor, Albanologji, Art, Arkitekturë, Kulturë, Arsim i Lartë etj. Presidenti i UBT-së, z. Hajrizi ka mbajtur edhe fjalimin e përmbylljes së kësaj konference.

UBT PARTNER I MICROSOFT PËR PROGRAMIN DREAMSPARK

Për herë të parë në Kosovë, UBT është partner i kompanisë Microsoft në programin DreamSpark.

DreamSpark është një program anëtarësimi i Microsoft -it që mbështet arsimin teknik, duke siguruar qasje në softuer që i përkasin kompanisë Microsoft për mësim, mësimitdhënje dhe qëllime kërkimore.

UBT ka siguruar abonimin Premium që mundësohet për Institucione Akadematike nga programi DreamSpark i Microsoft-it për të gjithë Studentet dhe Stafin akademik.

Të gjithë studentët dhe stafi akademik i institucionit më të madh të arsimit të lartë do të kenë mundësi shfrytëzimi të këtij Programi pa pagesë.



Softuerë të të gjitha kategorive duke përfshirë këtu Sistemet Operative, Veglat për Zhvillim, Serverët dhe programet e ndryshëm aplikativ e që në tërësi janë 197 Licenca do të jenë në shërbimin tuaj duke filluar nga viti i akademik pa pagesë.

Qasja juaj në këtë platformë do të rregullohet nga administrata ku ju do të keni mundësi shkakimi të Softuerëve dhe marrjes së licencave pa pagesë.

UBT tanimë në fushën e Edukimit Universitar është sinonim i Cilësisë dhe Inovacionit

PRAKTIKAT MË TË MIRA TË UNIVERSITETIT TË AACHENIT DO TË ZBATOHEJN EDHE NË UBT

Universiteti RWTH Aachen është pjesë e “Iniciativës për ekselencë” dhe renditet si një ndër universitetet më të mira në Republikën Federale të Gjermanisë

Prishtinë, 20 maj 2014- Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë qëndrimit të tij dy javor, në vazhdim të aktiviteteve të shumta që zhvilloi në Republikën e Gjermanisë, me ftesë të Universitetit RWTH Aachen, ka vizituar edhe këtë universitet.

Gjatë vizitës z. Hajrizi, i cili u prit nga rektori i Universitetit të Aachen-it, vizitoi fakultetet dhe institutet e ndryshme që funksionojnë në kuadër të tij.

Tema kryesore e bisedave ishte transferi i dijes nga universiteti në shoqëri.

“Vizita njëjavore në Aachen shërbeu si një mundësi shumë e mirë për UBT-në, për shkëmbimin e eksperiencave dhe mundësive të bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet RWTH dhe UBT-së”, tha presidenti i UBT-së, z. Hajrizi.

Z. Hajrizi shtoi se si rezultat i këtij takimi, UBT-së i është ofruar mbështetje dhe bashkëpunim në fushën e hulumtimeve të përbashkëta, regjistrim në programet e doktoratës për stafin dhe studentët e UBT-së, realizimi i praktikave në firmat gjermane, punimi i diplomave me mentor nga RWTH Aachen, aplikimi në projekte të përbashkëta për hulumtim dhe zhvillim në të gjitha nivelet e mundshme, realizimi i një benchmark-u ndërmjet RWTH Aachen dhe UBT, mbajtja e ligjëratave të përbashkëta, bashkëpunim mes qendrave për transferim të teknologjisë dhe ndërmarrësisë etj.

Kontribut të jashtëzakonshëm në hartimin e këtij programi bashkëpunimi ka dhënë dr. Dietrich Brandt, një bashkëpunëtor i rëndësishëm nga ky Universitet, i cili ka qenë dhe iniciatori i shumë nga formave të parashikuara të bashkëpunimit.

Universiteti RWTH Aachen është pjesë e “Iniciativës për ekselencë” dhe renditet si një ndër universitetet më të mira në Republikën Federale të Gjermanisë.



Tema kryesore e bisedave ishte transferi i dijes nga universiteti në shoqëri

UBT NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE “PERCEPTIMI I BOTËS PËR BASHKIMIN EVROPIAN”

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe ligjëruesi në UBT, Emrush Ujkani morën pjesë në konferencën ndërkombëtare “Perceptimi i botës për Bashkimin Evropian”, të organizuar nga Instituti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Qendra për Evropën në Universitetin e Varshavës, në bashkëpunim me Asociacionin Polak për Studime Ndërkombëtare.

Në paraqitjet e tyre, ata prezantuan perspektivën evropiane të Kosovës. UBT ka një bashkëpunim disaveçar me Universitetin e Varshavës dhe në veçanti me Institutin për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Qendrën për Evropën në këtë universitet.

ORGANIZATA SPINOFF E UBT-SË IPC CERTIFIKOHET SIPAS STANDARDIT NDËRKOMBËTAR PËR CILËSI ISO 9001:2008



Organizata spinoff e UBT-së IPC (International Professional Evaluation and Certification) është certifikuar sipas standardit ndërkombëtar për cilësi ISO 9001:2008

Kjo Organizatë tani më është validuar edhe nga IPMA për certifikimin e personave për Menaxhimin e Projekteve. ISO 9001 është një kriter i rëndësishëm për punë të mëtutjeshme sidomos në aspektin ndërkombëtar.

University of Warsaw






Bachelor and Master Degree in International Relations

Apply for Scholarship!

Teaching and Research Areas

- International Politics
- International Political Economy
- Culture and Multiculturalism
- Diplomacy and Foreign Policy
- International Law and Institutions
- Security and Strategic Studies
- European Integration
- International Relations Theory
- Emerging Markets
- International Business



University of Warsaw (UW)

Is known as one of the leading academic and research center in Poland. The high level of scientific research, its connection with the education of students and the diversity and attractiveness of our teaching determines the position of the University in the country and worldwide.

UW Highlights:

- Founded in 1816
- In the top 4% World-Class Universities
- Ranked no.1 in Poland
- Ranked by QS Topuniversities, The times THEWUR,
- Top 500 in Shanghai Group
- One of the most modern library in Central Europe

Institute of International Relations:

- Established in 1976
- Worldwide research cooperation
- Visiting Professors from all over the World
- Active in national and international research
- Bachelor, Master level and PhD degrees in English
- Worldwide student exchange programme

Fees & Financing:

Bachelor: 1300 € / Year
 Master: 2000 € / Year

The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

Come to UBT and get European degree

TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS



Email: warsaw@ubt-uni.net
 Email: ismn@uw.edu.pl
 Institute of Warsaw
 www.ism.uw.edu.pl

Danube University Krems




Master of Business Administration - MBA

Specializations with MBA Program

- Aviation
- Business Performance Management
- Corporate Responsibility & Business Ethics
- E-Mobility Management
- Energy & Carbon Management
- Finance
- International Business
- Marketing & Sales
- Strategic Management & Organizational Change
- Enterprise Project Management

Apply for Scholarship!

Fees & Financing

Tuition fee: Euro 21,900
 Please note our **Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 10,950

The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

Danube University



Danube University Krems has specialized in postgraduate academic studies and offers exclusive courses in the fields of health and medicine, communication and globalization, business and law, education and media as well as of arts, culture and building. Being a European model project, Danube University Krems combines high quality in education, research and consulting with excellent customer orientation and service. More than 5,000 students from 80 countries are enrolled in over 150 academic courses.

Department for Management and Business

We believe strongly in a long life learning that prepares and enables you to become a responsible business leader in a fast changing world. We place strong emphasis on learning-by-doing approach, and strive for creating an innovative environment that enables you to have a high caliber education and training. As we are well located in Central Europe, you will enjoy a multicultural and international faculty and student body. The Danube Business School provides an environment where East meets West with strong links to the business community and relationships with partners from both Eastern as well as Western European countries.

Top 10 Reasons to Join a Danube MBA

- An integrative and applied approach to learning
- Long expertise in postgraduate education
- Customized high standard programs
- High calibre and international faculty
- Flexibility for both full-time and part-time students
- Campus located in the picturesque Wachau region
- International student body
- International study trips
- Individualized quality service
- More than 2000 alumni

Top University Education for Top Students!

TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS



Email: dukmba@ubt-uni.net
 Email: michaela.moser@donau-uni.ac.at
 Tel: +43 (0)2732 893 2126
 Web: www.donau-uni.ac.at

Vienna University of Technology





Msc Engineering Management

Your key to the top engineering league



CONTENTS

Business • Engineering Informatics • Production • Master's Thesis

MODALITIES

3 semesters, part-time, 14 weekend tracks, in English,

PROGRAM START

January 23, 2014

APPLICATION DEADLINE

November 15, 2013

INFORMATION SESSION

October 4, 2013

Apply for Scholarship!

FEES & FINANCING

Tuition fee: Euro 22,000
 Please note our **KAMM Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 13,000

The KAMM Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

HIGHLIGHTS

- 17 years experience
- Master of Science Degree of Vienna University of Technology
- Executive program
- International Faculty - Universities and Industry
- International Participants - Worldwide
- Top international faculty from Europe and USA
- Part time - 14 weekend modules (Thursday to Sunday)
- According to the Bologna Convention
- Contents modernized continuously
- Evening lectures of distinguished guest speakers
- Company visits
- Sustainable Learning Environment – with your tablet at the university (included in the price)
- Alumni Club related to IEEE
- Regularly Club meetings for Networking
- From our graduates approximately 2/3 are in (high) management positions, 1/3 founded a company



Top University Education for Top Students!

Our mission is "technology for people". Through our research we "develop scientific excellence", through our teaching we "enhance comprehensive competence".

Vienna University of Technology
Continuing Education Center
 Operngasse 11 • A-1040 Vienna
 T +43(0)1/58801-41701 • engineering@tuwien.ac.at
 Email: engineering@ubt-uni.net
 http://engineering.tuwien.ac.at



SKENARISTI I ZYMBER KELMENDI TREGOI GJITHÇKA RRETH FILMIT "TRI DRITARE DHE NJË VARJE"

"Fuqia e filmit është e jashtëzakonshme. Nuk ka ekran që e zëvendëson pëlhurën e kinemasë. Vetëm ajo është magjike", thotë skenaristi Kelmendi.

UBT News: Cila është tema kyçe e filmit?

Zymer Kelmendi: Tema e filmit ka të bëjë me pasojat e dhunimit gjatë luftës në Kosovë. Shikuar nga aspekti tematik, kemi të bëjmë me një temë që, ashtu si të gjitha temat e tjera janë trajtuar në një mënyrë apo në një tjetër në kinematografi. Interes të veçantë si këtu si jashtë vendit ka zgjuar këndvështrimi i problemit. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një këndvështrim të burrave karshi problemit të dhunimit në luftë.. Dua të potencoj një gjë me këtë rast; shumicën e rasteve këtu, kur i janë referuar skenarit, i janë referuar si "temë". Kjo gjë nuk qëndron. Lufta, dashuria, dhuna, xhelozia... janë me mijëra filma me këto tema. Nuk ke çka zbulon me. E rëndësishme nuk është çka shkruhet, por si shkruhet. Skenari nuk është tema. Tema e një filmi asnjëherë nuk deklamohet; ajo mund të lexohet brenda një skene apo edhe një fjalë të vetme. E skenari është shumë më tepër. Është struktura, është ndërthurja apo ajo që një teoricien i filmit e quan edhe si "renditje e emocioneve". Për mua me rëndësi në këtë rast ka qenë që të kem një çasje me të veçantë karshi kësaj teme. Dhe duket se ka funksionuar. Të paktën këtë përshtypje e kam nga Premiera Botërore në Sarajevë, e poashtu edhe nga Premiera në Prishtinë.

UBT News: Si lindi ideja që pasi e shkruat metrazhin e shkurtër që ta bëni atë të gjatë?

Zymer Kelmendi: Është e vërtetë që filmi, gjegjësisht skenari është bërë fillimisht si film i metrazhit të shkurtër, me regji të Faton Bajraktarit, dhe natyrisht me skenar timin, dhe pastaj është zgjeruar edhe si skenar për film të metrazhit të gjatë. Ka qenë ndoshta kjo sprova e parë që t'i hyj më thellë trajtimit të kësaj problematike në aspektin e skenarit, që ka rezultuar me një pritje afirmuese nga ata që kanë parë filmin, duke krijuar siguri për të vazhduar tutje.

Natyrisht se në këtë rast meritë të veçantë ka prof. Isa Qosja, i cili

pasi e kishte shikuar këtë film (të metrazhit të shkurtër), shprehu interesim që unë t'i hyja punës për skenarin e filmit që është tani, pra "Tri dritare dhe një varje". Përveç që skenari është bërë me i gjatë, po ashtu më i gjatë është bërë edhe titulli, ngase më herët ishte vetëm "Tri dritare", kurse në versionin e gjatë është "shtuar", edhe një "varje".

UBT News: Çka e dallon "Tri dritare dhe një varje" nga filmat e tjerë?

Zymer Kelmendi:Nëse i hyj një krahasimi të tillë, do tingëlonte subjektive çka do që them. Paraprakisht mendoj se në Kosovë bëhen shumë pak filma. E kam fjalën për metrazh të gjatë. Fatkeqësisht. Pa dashur që të bëj kritikun, apo të vë theksin në ndonjë nga projektet e pasluftës, përfshirë edhe "Tri dritare...". Ajo që mua si skenarist më ka rënë në sy si e metë, në pjesën dërrmuese të filmave që janë bërë, ka qenë dëshira për të "përmbledhur" gjithë problemet e një shoqërie, apo epoke të caktuar brenda një filmi. Rrjedhimisht brenda një ore e gjysmë apo edhe dy orë. Kjo sikur e ka stërngarkuar secilën linjë të filmave, dhe ka bërë që publiku të "stërngopet" me atë që i është ofruar. Dhe ka munguar një gjë- impakti emocional. Shumë njerëz mund të mospajtohen me mua, por ky është mendimi im.

Në kinematografi vlen një thënie që "nëse një shikues del nga kinemaja, me të njëjtin emocion që ka hyrë në kinema, ai ka të drejtë të kërkojë të hollat e biletes". Prapë pa dashur të bëj krahasime, e them me sinqeritetin më të madh se çdo njeri që kam takuar, pasi ka shikuar filmin "Tri dritare...", e ka thënë se filmi e ka emocionuar shumë. Natyrisht se, si skenarist, kjo gjë më bën të ndjehem mirë. E përveç veçorive që sjell skenari, pastaj kemi të bëjmë me qasjen regjisoriale, aktrimin e shumë elemente të tjera që e dallojnë një film nga një tjetër.

UBT News: Me cilat çmime është shpërblyer filmi?

Zymer Kelmendi:Filmi fillimisht është mbështetur nga QKK (Qendra Kinematografike e Kosovës). Më konkretisht në Konkursin vjetor për projekte që hap QKK. Skenari ka fituar përkrahjen apo poentimin më të madh. Kjo ka hapur rrugë pro-

jektit për të konkurruar edhe në konkurse të tjera. Një punë shumë të madhe në këtë rast kanë bërë edhe producentët Shkumbin Istrefi dhe Mentor Shala. Poashtu projekti qysh në fazën përgatitore ka fituar në Cottbus të Gjermanisë çmimin "BestPitchAward" në "14th East-WestCo-productionMarket" në kuadër të Festivalit ConnectingCottbus të mbajtur në nëntor 2012. Pastaj në vitin 2013, në edicionin e 19-të të Festivalit të Sarajevës, në Seksionin "Work in Progress", filmi ka fituar çmimin e parë, çmim ky që jepet nga kompania prestigjioze e post-produksionit "Post Republic" nga Berlina e që ka vlerën prej 80 mijë euro shërbime të post-produksionit. Kurse pas Premierës botërore, që ishte muajin e kaluar në Sarajevë, ku edhe mori çmimin CineEurope. Filmi para pak ditësh fitoi edhe "Gladiatorin e artë" në Festivalin ndërkombëtar të filmit në Durrës. Dhe kjo ndodhi në mesin e një numri filmash, te punuar nga filmbërës me emër në Evropë dhe botë. Mbetët të shohim tutje, pasi filmi është i ftuar në disa Festivale të rëndësishme ndërkombëtare.

UBT News: Sa jeni të kënaqur me rolet në këtë premierë?

Zymer Kelmendi:Skenaristët, kur shkruajnë për film, zakonisht kanë ndonjë aktor në kokë që e shohin bazuar në konturat e personazhit që e krijojnë. Por ndarja e roleve, pothuajse asnjëherë, për të mos thënë kurrë nuk është çështje e skenaristit. Ështëpunë e regjisorit, producentit. Mund të ndodh vetëm ndonjë sugjerim por asnjëherë vendimmarrje lidhur me këtë pjesë të filmit.

E them pa asnjë dilemë se aktimi, mishërimi me personazhet i bërë nga aktorët në këtë film për mua ka qenë pjesë shumë e fortë e gjithë filmit. Kjo duke ju falënderuar aktorëve si Luan Jaha, Irena Cahani, Donat Qosja, Aurita Agushi, Leonora Mehmetaj, pa i përmendur të gjithë, e veçanërisht regjisorit Qosja i cili ka bërë një punë të jashtëzakonshme edhe në këtë aspekt. Qoftë me përgjedhje poashtu edhe me qasjen e secilit karshi personazhit.

UBT News: Ju si skenarist, sa mendoni që ju jepet hapësirë e duhur të shprehni talentin tuaj në lidhje me tematika paksa delikate?

Zymer Kelmendi: Përderisa filmi është art kolektiv, pra nuk kemi të bëjmë me një punë të kryer, së puna është kryer nga një person, është gogja e vështirë të flasim për hapësirë krijuese. Një piktor, apo një poet shpërfaq gjithë talnetin dhe profesionalizmin e tij në pikturë apo letër dhe të tjerët e pranojnë ose jo atë që ai ka bërë. Në filmi nuk shkon kështu. Jo. Në momentin kur shkruhet skenari kalon te njerëz të tjerë. Thirren prapë të tjerë... Përgatitje, xhirime... pra është proces jo i shkurtër dhe jo i lehtë që të kemi një film.

I përmenda të gjitha këto sepse nuk kemi të bëjmë me një hapësirë krijuese të cilën e gjen apo nuk e gjen një skenarist. Supozojmë se mund të ketë skenarë shumë interesantë, shumë të fuqishëm, por një skenar i tillë mund të jetë shumë i kushtueshëm për tu bërë film. Pra nuk kemi të bëjmë me mungesë talenti nga skenaristët, por me mungesë buxheti për të bërë film. Fatkeqësisht skenarët nuk janë letërsi të lexohen nga masa. Ata i dedikohen filmit, dhe përderisa nuk bëhet film ai skenar nuk ekziston. Askush nuk flet për të. Dhe si të tillë ne nuk mund t'i vlerësojmë.

UBT News: Mesazhi për studentët lidhur me kinematografinë?

Zymer Kelmendi: Fuqia e filmit është e jashtëzakonshme. Një studiues mitesh, e rrëfen një udhëtim të tij, kur ai ishte në një vend të thellë afrikan. Kur ai viziton një vendas, e kupton se në shtëpinë e tij nuk ka asgjë. Madje as vend për të fjetur. Thjeshtë në tokë. Por ajo që i bie në sy është një poster filmi, nga filmi "Ethet e së shtunës mbrëma"! Kjo është forca e filmit. Magjia e filmit. Art që ka depërtuar në çdo shtëpi. Thjeshtë ne çdo shpirt. Të shikosh një film nuk do të thotë të humbasësh dy orë. Përkundrazi, do të thotë të hysh në një botë, dhe për dy-tri orë të bashkëjetosh me personazhe, fate, situata, ambiente nga më të ndryshmet dhe me interesantet. Këtë e ofron vetëm filmi. Shikoni sa më shumë filma, e sidomos në kinema. Nuk ka ekran që e zëvendëson pëlhurën e kinemasë. Vetëm ajo është magjike.

Albina Zeneli

MUZIKË

TOP 15 HITET E 2014-tës




Vera e vitit 2014 është karakterizuar me një laramani këngësh të cilat mbërritën të ruheshin në arkivin e secilit këngëtar.

Qëllimi i vetëm i tyre ishte mbërritja në një stad më të lartë të karrierës në mënyrë që publiku t'i mbajë mend një kohë të gjatë. Pati edhe bashkëpunime, disa rezultuan të suksesshme e disa edhe dështuan, disa shënuan në shenjë e disa "ia huqën". Rivalitetet artistike krijohen zakonisht nga vetë këngëtarët të cilën gjë parësore e kanë muzikën por edhe kanë dëshirë të dominojnë në skenë. Ky vit është karakterizuar me bashkëpunime.

Se cilat janë këngët që lanë shije më të mirë në skenën shqiptare i ndjekim në vazhdim. Renditja është bërë në bazë të klikimeve që i posedojnë në Youtube.

1. Enca – A Pot Pelqen
2. Tuna&Geti - MMV
3. Ledri & Dafina Zeqiri – Got Your Back
4. Skivi Ft.Mimoza Shkodra & Nora Istrefi - Na
5. Blunt Ft. Real I & Ledri – Nesem' Don Ti
6. Arilena Ara – Si Aeroplan
7. Kida & McKresha – Rikthejm Na
8. Nora Istrefi – Baby Jem
9. Silva Gunbardhi & Dafi – Tequila
10. Elita 5 – Më Fal
11. Genta & Ardian Bujupi - Feel
12. Samanta & Onat – Ti Se Din Se
13. Alban Skenderaj & Young Zerka – 24 Orë
14. Elvana Gjata - Puthë
15. Dhurata Ahmetaj & Blero – Shumë O Ka Ma Don



TUNA

Albina Zeneli

HITE NDËR VITE

Disa këngë legjendare nuk harrohen kurrë. Vitet 1990-2000 ishte një dekadë e artë për artistët shqiptarë që sollën këngë që ruhen në zemrën dhe mendjen e çdo njeriu.

Në vazhdim ndiqeni një listë të këngëve që lanë gjurmë të pashlyshme në muzikën tonë.

1. Minatori – Pse Shkove Ti
2. Eliza Hoxha – Me Ritëm Do Vallëzoj
3. Leonora Jakupi – A Vritet Pafajësia
4. Agron Berisha – Vetëm 5 Minuta
5. Gjurmët – Në Tren Për Perzeren

6. Edona Lalloshi – E Kam Emrin Kosovar
7. Ilirët – Xhamadani Vija Vija
8. Pirro Cako & Rovena Dilo – Unë E Ti
9. Gili & Ardit Stafaj – Ditët E Fundit
10. Adelina Ismaili - Amaneti

11. Leonora Jakupi – Ti Nuk Ekziston
12. The Dream – Nuk Dua Ta Di
13. Elita 5 – Faleminderit
14. Genta – Kthehu
15. Edona Lalloshi & Memli – Simpatia